

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.12(378)

DHJETOR 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

KRONIKA



Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore

FAQE 5

PROFIL



Prof. ASOG. DR. Zaho GOLEMI

DËSHMORËT NË RRËNJËT E LIRISË SË SHQIPTARIZMIT

FAQE 4

PROMOVIMI



LANÇ NË DIBËR, ME GJURMË NË HISTORI

Sakip Cami promovon librin e 20-të **FAQE 12**

Qeveria shpall gjendjen e jashtëzakonshme për një periudhë 30 ditore

Ditë tragjike për Shqipërinë, solidaritet i paparë

Të bashkuar deri në rikthimin e normalitetit

Halil RAMA

Kreu i shtetit, Ilir Meta, doli me një mesazh solidariteti në Ditën e Flamurit. "Në këtë ditë që është më e rëndësishmja për shtetin dhe kombin tonë, por që na gjeti në zi dhe në betejë me pasojat e tmerrshme të një tërmeti të pamëshirshëm, ju ftoj të angazhohemi për të nderuar Flamurin tonë Kombëtar dhe të qëndrojmë të bashkuar deri në rikthimin e normalitetit të plotë të jetës për të gjithë familjet shqiptare dhe fëmijët e tyre", - theksoi Presidenti Meta. Këtë ditë të bekuar të kombit tonë ai e nisi duke vizituar familjet që kanë mbetur pa strehë në Sukth, ku takoi edhe Amelian, e cila edhe pse ka dy ditë që jeton në çadër e në kushte të veshitira, më 28 Nëntor kishte zgjedhur të vishej me ngjyrat e Flamurit Kombëtar. "Sa më shumë të bëjmë sot për këta fëmijë, aq më shumë ata do ta nderojnë Flamurin tonë Kombëtar dhe shtetin e tyre kur të rriten", - u shpreh Meta i mallëngjyer.

Në të vërtetë, goditja e pabesë e natyrës dhe shenja që na dha Zoti duhet ta bëjnë elitën tonë që të kuptojë se jo vetëm këto ditë post tragjedisë, por se ka vend për njerëzillëkun e vazhdueshëm edhe brenda politikës. Ka jetë edhe përtej cic-mic-eve dhe banaliteteve të përditshme. E mbi të gjitha, se vetë jeta ka gjëra shumë më të shenjta e të shtrenjta, sesa vetëm ëndrrat me karrige e pushtet, me çdo çmim, me çdo mjet e me çdo kusht.

Lëkundjet e frikshme të tërmetit për pak sa nuk shkaktuan një katastrofë. Duke na dhënë me këtë rast jo vetëm një mësim, por edhe një mundësi të re e të madhe, për reflektim të thellë. Një shans të ri për të kuptuar se ato që na bashkojnë janë shumë herë më të shtrenjta, sesa ato që na ndajnë nëpërmjet politikës. "Tragjedia e jetës, - thoshte Benxhamin Franklin, - është se ne plakemi shpejt dhe bëhemi të urtë shumë vonë". Edhe solidariteti i klasës sonë politike pas tërmetit shkatërrimtar, ishte një akt i vonuar. Por, edhe ky rast vërtetoi se kurrë nuk është vonë për të bërë gjëra të mira.



- *Tërmeti me magnitudë 6.4 ballë të shkallës Rihter që goditi Shqipërinë, kryesisht Durrësin. Thumanën dhe Tiranën më 26 Nëntor 2019, ora 03.54 ka krijuar tragjedi të njëpasnjëshme për shqiptarët gjatë asaj dite dhe në ditët në vijim. Në këtë situatë tragjike, qeveria shqiptare ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në rajonet Tiranë dhe Durrës për 30 ditë, vetëm një ditë pas tërmetit shkatërrues që ka marrë 50 jetë njerëzish, ndërkohë që frika mbetet ende pezull pasi bilanci edhe mund të rritet*

FAQE 3

SOLIDARITETI

Në orë e ditë nevojë ne jemi një komb i bashkuar. Shqipëria e vërtetë është ajo e njerëzve me zemër dhe forcë të madhe



OBVL anullon veprimtaritë festive, mesazh solidariteti në 107 vjetorin e Pavarësisë dhe 75 vjetorin e çlirimit

FAQE 3

REPLIKA

SHBA & NATO mbeten jetike për sigurinë dhe vlerat Euroatlantike

Gjeneral Piro AHMETAJ **FAQE 5**

JUBILARE

75 VJET MË PARË U ÇLIRUA GJAKOVA

Nga Bashkim Hisari **FAQE 7**

PROFIL

Për Sami Kuçin, Drobonik Berat

Mohimi i luftës për çlirimin e vendit rivrasje të atyre që sakrifkuan dhe dhanë jetën

FAQE 10

HISTORIA

SADI SINANI, DËSHMOR I PARË I PEZËS

Nga: Liliana Muça **FAQE 9**

REPORTAZH

FUNDJAVË SHKENCORE NË METEORA

Dr. Leonidha Peppo **FAQE 11**
Kardiolog - Poliklinika nr 4, Tirane

SOLIDARITET

Shqipëria paçka se është goditur nga tërmeti me shumë viktima, 28 Nëntorin e ka një ditë të veçantë

Mes gërmadhave gjendet flamuri shqiptar, ja gjesti i rrallë i një zjarrfikësi

Një zjarrfikës shqiptar, në orët e para të mëngjesit të 28 Nëntorit 2019, i ndodhur me shërbim të Thumanë ka bërë gjestin më të rrallë. Ai ka nxjerrë nga rrënojat një flamur kombëtar, mesa duket e ndonjë familjeje që i është bashkuar nismës "Flamur në çdo ballkon për festat e nëntorit".

Shqipëria paçka se është goditur nga tërmeti me shumë viktima, 28 Nëntorin e ka një ditë të veçantë. Dita e Flamurit, pavarësisht se këtë vit nuk ishte një ditë feste,

zjarrfikësi shqiptar e ka përkujtuar me mënyrën e tij, aty mes rrënojave teksa ishte në operacion-kërkim shpëtimi.

Gjestin e tij, e kanmë përshëndetur mijëra shqiptarë. Pjo për faktin se flamuri, që u gjet mesnatën e 28 Nëntorit, shumë pranë viktimave të fundit të nxjerra nga gërmadhat në Thumanë, sikur i ndriçoi sytë dhe zemrat e heronjve shqiptarë, që edhe me thonj kanë



gërmuar pa pushim për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej. Ishte ky flamur, i nxjerrë nga rrënojat, që për pak çaste e largoi dhimbjen e përzishme dhe ktheu dritën e shpresës.

Le të jetë ky flamur, lutja jonë për shpirtat e atyre që e lanë pas, si simbolin më të lartë që bën bashkë shqiptarët kudo që janë dhe mesazhi ynë për nderimin e Festës sonë kombëtare.

“Nuk vret tërmeti por ndërtimet”- Sizmologu: Pas tërmetit më të fortë në 40 vite, janë regjistruar mbi 550 lëkundje

Mbi 550 tërmete kanë ndodhur gjatë ditëve të fundit pas tërmetit të fortë të mëngjesit të së martës së 26 Nëntorit 2019 me magnitudë mbi 6.4 ballë.

Sizmologu Edmond Dushi në një intervistë për “Panorama.al”, thekson se lëkundjet do të vazhdojnë, por qetëson qytetarët e Tiranës se nuk do të kenë pasojë. Sipas tij, kjo situatë mund të zgjasë edhe disa javë, duke marrë parasysh eksperimentat e mëparshme. Sizmologu Edmond Dushi thekson: “Situatë vazhdon të jetë e ngarkuar në aspektin sizmik. Deri më tani janë regjistruar rreth 550 pas goditje. Vazhdojnë të bien. Ka ndodhur edhe një pasgoditje e fortë pasditen e sotme (27 nëntor) me magnitudë 5.3 të shkallës rihter. Kjo është krejt normale. Për sa kohë trendi i goditjeve vazhdon të jetë gjithnjë e më i ulët në raport me goditjen kryesore, është tregues i qartë i relaksimit në zonën tërmetore. Për mendimin nuk është për të bërë shqetësim në qytetin e Tiranës e cila është rreth 30 km në vijë ajrore.

Nuk është hera e parë që Shqipëria goditet nga tërmetet, por është hera e parë që në këto 40 vitet e fundit, që është goditje kaq e fortë. Në çdo rast pas një goditje të fortë do të përvijohet me një numër të madh pas goditjesh. Ky është një fenomen natyror që karakterizohet në këtë mënyrë. Jo pa qëllim ne themi që nuk është shqetësuese përderisa magnituda është me trend zbritës, efekti është shumë herë më i vogël. Zona siç është Tirana nuk përbëjnë shqetësim momental, kjo përbën shqetësim në zonat e dëmtuara. Për më tepër, duhet që njerëzit atje ku ka dëmtime të konsultohen me ekspertë në terren për këtë qëllim që të jenë më të kujdesshme. I kthehemi shprehjes, nuk vret tërmeti por vrasin ndërtimet.

OBVL dhe Shtëpia Botuese “M&B” prezantojnë librin e 20-të të publicistit, poetit e shkrimtarit Sakip Cami

“LANÇ në Dibër”, vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar (OBVL) dhe Shtëpia Botuese “M&B”, në vigjilje të jubileut të lavdishëm të 75-vjetorit të çlirimit të atdheut, promovuan librin “LANÇ në Dibër”, që u vlerësua si një ndër veprat më të arritura të publicistit, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami. Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, Kryetari i OBVL kol.ing.Myfit Guxholli, prof. dr. Bernard Zotaj, prof.dr.Zaho Golemi, nënkryetari i OVLANÇ të Kosovës Bashkim Hisari, kreu i Unionit të Krijuesve dritanë Fatos Daci, historiani Mehmet Hasani, ish-ministria e Arsimit Tefta Cami si dhe botuesi Bujar Karoshi evidentuan vlerat e këtij libri që mbush vaakumin e krijuar për një nga periudhat më të lavdishme të historisë së Shqipërisë. Ky libër që u promovua më 24 Nëntor 2019 në sallën “Shpataraku” të Muzeut Kombëtar në prani të elitës intelektuale dibrane dhe personaliteteve tjera akademike të kryeqytetit, i botuar në kuadrin e 75-vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist, hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë dokumentare.

Redaktori i librit “LANÇ në Dibër”, z.Halil Rama, që ishte dhe moderator i këtij aktiviteti promovues, ndër të tjera tha se “LANÇ në Dibër” është libri që hedh dritë për ngjarje e fakte të mbetura disi në errësirë, ose të shtrembëruara qëllimisht e të pasyruara si të tilla nga historiografia e viteve të para ‘90-tës. Sipas tij, “LANÇ në Dibër” është një vepër dinjitoze e autorit S.Cami që pasuron dukshëm fondin e letërsisë sonë dokumentare. Kjo edhe për faktin se autori pasqyron me përgjegjësi ngjarje e fakte historike nga aktiviteti i çetave luftarake (Të Dibrës e të Gollobordës, të Batalionit partizan të Dibrës e Brigadës XVII S, si dhe pasqyron veprimtarinë e misionit anglez në Dibër të shoqëruar pothuajse gjatë gjithë kohës nga Dan Kaloshi. Po ashtu autori sjell referencat mjaftë të besueshme nga: Prof.Bernd

- Në këtë aktivitet promovues të librit të autorit Sakip Cami “LANÇ në Dibër”, interes të jashëzakonshëm ngjalli kreu i OBVL, kol.ing.Myfit Guxholli. Si pjesëmarrës aktiv në LANÇ, ai rrëfeu për pjesëmarrësit kohën kur i inkadruar në Brigadën e IV-t Sulmuese mori pjesë në luftimet në Zërqan, Dibër të Madhe e Peshkopi, kundër pushtuesve gjermanë dhe mercenarëve vendas të lidhur me pushtuesin.
- Duke përshëndetur pjesëmarrësit e shumtë në këtë aktivitet promovues, zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi vlerësoi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si një zgjedhje politike dhe ushtarake të mençur dhe dinjitoze të popullit shqiptar. Pasi përgëzoi autorin Sakip Cami për këtë vepër dinjitoze, numri dy i dikasterit të Mbrojtjes tha se: “LANÇ ishte një përcaktim politik dhe ushtarak i Shqipërisë në krahun e duhur gjatë Luftës së II-të Botërore. Jemi krenarë për mençurinë, sakrificën dhe përkushtimin ushtarak të partizanëve që bënë LANÇ dhe të popullit tonë antifashist”



Ficher, Reginald Hibbert, Fondi i Gjeneral Alberto Parianit (mars-korrik 1943), Neubacher (I dërguar special i Hitlerit për Ballkanin) e nga dhjetra botime të autorëve shqiptarë, duke u ndalur veçmas tek Lufta kundër fashistëve italianë në Dibër e Dibër të Madhe; Lufta kundër nazistëve gjermanë në Dibër si dhe tek Lufta e njësive të mëdha partizane. Kryeredaktori i gazetës “Veterani” H.Rama, njëherësh redaktor i këtij libri vlerësoi gjithashtu mënyrën dhe stilin e veçantë të të shkruarit nga autori. S.Cami. Duke përshëndetur pjesëmarrësit e shumtë në këtë aktivitet promovues, zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi vlerësoi Luftën

Antifashiste Nacionalçlirimtare si një zgjedhje politike dhe ushtarake të mençur dhe dinjitoze të popullit shqiptar. Pasi përgëzoi autorin Sakip Cami për këtë vepër dinjitoze, numri dy i dikasterit të Mbrojtjes tha se LANÇ ishte një përcaktim politik dhe ushtarak i Shqipërisë në krahun e duhur gjatë Luftës së II-të Botërore. “Jemi krenarë për mençurinë, sakrificën dhe përkushtimin ushtarak të partizanëve që bënë LANÇ dhe të popullit tonë antifashist”, tha z.Koçi. Më tej, duke reaguar kundër spekulantëve dhe shtremëruar të historisë së LANÇ, ai tha se “shqiptarët janë dhe do të mbeten antifashistë! Nuk u turpëruan dot gjatë



Luftës së II-të Botërore dhe nuk i turpëron dot askush”. Zëvendësministri i Mbrojtjes vlerësoi heronjtë dhe dëshmorët e LANÇ si simbolin më kuptimplotë të nacionalizmit me vepra dhe jo me fjalë. Dhe padyshim, ai që ngjalli interes të jashëzakonshëm në këtë aktivitet promovues të librit të autorit Cami “LANÇ në Dibër”, ishte kreu i OBVL, kol.ing.Myfit Guxholli. Si pjesëmarrës aktiv në LANÇ, ai rrëfeu për pjesëmarrësit kohën kur i inkadruar në Brigadën e IV-t Sulmuese mori pjesë në luftimet në Zërqan, Dibër të Madhe e Peshkopi, kundër pushtuesve gjermanë dhe mercenarëve vendas të lidhur me pushtuesin.

(Vijon në faqen 12)

SOLIDARITETI

Qeveria shpall gjendjen e jashtëzakonshme për një periudhë 30 ditore

Ditë tragjike për Shqipërinë, solidaritet i paparë

Një nga katastrofat më të rënda natyrore në historinë e Shqipërisë për dhjetëvjeçarët e fundit ka shkaktuar më shumë se 40 të vdekur dhe me qindra të plagosur.

Tërmeti me magnitudë 6.4 ballë të shkallës Rihter që gtditi Shqipërinë, kryesisht Durrësin dhe Tiranën më 26 Nëntor 2019, ora 03.54 ka krijuar tragjedi të njëpasnjëshme për shqiptarët gjatë asaj dite dhe në ditët në vijim. Në këtë situatë tragjike, qeveria shqiptare ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme vetëm një ditë pas tërmetit shkatërrues që ka marrë mbi 40 jetë njerëzish, ndërkohë që frika mbetet ende pezull pasi bilanci edhe mund të rritet.

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të qeverisë kryeministri Rama pohoi se nuk është thjesht çështje financash. “Po shpallim gjendjen e jashtëzakonshme bazuar në Kushtetutë. Ash-tu si Kushtetuta dhe legjislacioni sht-jellojnë, duke nisur nga natyra dhe perimetri i situatës do të jetë gjendje e jashtëzakonshme për dy rajonet e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë, Tiranën dhe Durrësin. Por për atë që

Tërmeti me magnitudë 6.4 ballë të shkallës Rihter që goditi Shqipërinë, kryesisht Durrësin. Thumanën dhe Tiranën më 26 Nëntor 2019, ora 03.54 ka krijuar tragjedi të njëpasnjëshme për shqiptarët gjatë asaj dite dhe në ditët në vijim. Në këtë situatë tragjike, qeveria shqiptare ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në rajonet Tiranë dhe Durrës për 30 ditë, vetëm një ditë pas tërmetit shkatërrues që ka marrë 50 jetë njerëzish, ndërkohë që frika mbetet ende pezull pasi bilanci edhe mund të rritet



nuk e dinë, gjendja e jashtëzakonshme nuk është çështje thjesht financash,

por e një sërë masave. E thashë dhe e thotë dhe historia jonë. Pasi

çështjen financiare se kemi lënë asgjë mangët. Nuk e di nëse janë të gatshëm ata që e predikonin gjendjen e jashtëzakonshme që tu nënshtrohen këtyre masave. Gjendja e jashtëzakonshme, për një periudhë 30 ditore, ka hapësirat dhe detyrimet për ata që duhet ta qeverisin atë. Mbase nuk do u vijë për shtat atyre që e kanë predikuar, pasi ka qenë një temë me të cilën mund të bënin politikë, pasi Shqipëria ishte në lot”, tha Rama.

Pikëllimin dhe dhimbjen për viktimat kreu i ekzekutivit e ka shprehur edhe në një apskt të veçantë. Teksa është pyetur për statusin e ndjerë në rrjetet sociale të djalit të tij, Gregu, pas humbjes së jetës së të resë Kristi Reçi dhe familjarëve të saj në Durrës, një intervistë për emisionin “Top Story”, Rama u prek dhe ndërpreu intervistën. Ai tha se sot i ka të gjithë si Gregun.

Në orë e ditë nevojë ne jemi një komb i bashkuar. Shqipëria e vërtetë është ajo e njerëzve me zemër dhe forcë të madhe



Europa në këmbë, solidaritet me Shqipërinë!

Pas tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë më 26 Nëntor 2019, erdhi një valë solidariteti nga Europa. Kancelarja Merkel i ka ofruar ndihmë emergjente Shqipërisë. Shumë vende të tjera fqinje e europiane tregohen solidare me Shqipërinë.

Pas fatkeqësisë së tërmetit në Shqipëri, Bashkimi European ka reaguar zyrtarisht përmes Federica Mogherinit, zëvendësprezident e BE dhe e ngarkuara në largim për Politikën e Jashtme si edhe komisionerit të BE, Christos Stylianides duke shprehur tronditjen për tërmetin shkatërrues që ka shkaktuar viktima në Shqipëri. “Shprehim ngushëllimin e thellë për njerëzit dhe autoritetet e shtetit. BE qëndron në solidaritet me Shqipërinë dhe është gati të ofrojë ndihmën e saj.” Mekanizmi European për Mbrojtjen e Civilëve dhe Qendra Koordinuese për Rastet e Emergjencave të BE (ERCC) kanë ofruar ndihmë dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet shqiptare.

Ndihmat e para mbërritën në kohë rekord në Shqipëri. Sipas njoftimeve të autoriteteve shqiptare, fqinjët e Shqipërisë, Italia dhe Greqia sollën avionët me ndihma në Shqipëri. Edhe Kosova dha ndihmë të konsiderueshme. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli shkruan, se “Kosova ka dërguar njësitë e saj për të ndihmuar autoritetet në këto momente të vështira”. Autoritete të larta nga Kosova kanë bërë të ditur dërgimin e forcave të ushtrisë dhe emergjencës.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, sipas njoftimeve, ka vënë në përdorim me-

kanizmin e ndihmës së emergjencës.

Edhe Mali i Zi dhe Serbia ishin gatshme të ndihmojnë Shqipërinë. Nga Mali i Zi dhe nga Serbia erdhën dy ekepe të specializuara për shpëtimin në raste katastrofash. Nga Rumania ndërkohë dy aeroplanë ushtarakë shpëtimi, mbërritën në Shqipëri edhe ndihmat nga Turqia.

Reagime pas tërmetit në Shqipëri erdhën edhe nga Presidenti i Parlamentit European, David Sassoli. Ai shkroi në twitter, se “jam thellësisht i prekur për lajmet e tërmetit shkatërrues në Shqipëri. E gjithë Europa është solidare me vendin dhe njerëzit.

Mendimet tona janë me viktimat dhe të dashurit e tyre.” Solidaritet me Shqipërinë ka treguar edhe fituesi i zgjedhjeve të fundit në Austri, dhe ish-kryeministri i Austrisë, Sebastian Kurz. “Mendimet e lutjet e mia janë me shqiptarët, veçanërisht me familjet e viktimave të tërmetit. Ne jemi të gatshëm për ndihmë.”

Edhe kryeministri i Bullgarisë, Boiko Borissov, i cili ka telefonuar kryeministrin Rama për të ofruar ndihmë, shkruan në titter se e ndan dhimbjen me shqiptarët në këto ditë të vështira dhe shprehim shpresën për shërimin sa më të shpejtë të të lënduarve e restaurimin e dëmeve materiale. Jemi gati të ndihmojmë.” Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, po ashtu ka ofruar ndihma në një telefonatë me kryeministrin Rama. Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Nikola Dimitrov shkruan se “jam thellësisht i prekur për lajmin e humbjes së jetëve në Shqipëri. Gati të ndihmojmë..

OBVL anulon veprimtaritë festive, mesazh solidariteti në 107 vjetorin e Pavarësisë dhe 75 vjetorin e çlirimit

Familjet e viktimave në Durrës e Thumanë kanë nevojë për solidaritetin tonë në këtë moment të vështirë. Sepse ata kanë nevojë të përbashkëta, një fat të përbashkët dhe një të ardhme të përbashkët. Ata po përballen me një tragjedi, ndaj më shumë se kurrë kanë nevojë për solidaritetin dhe ndihmën tonë

Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) anuloi të gjitha veprimtaritë festive me rastin e Ditës së Pavarësisë dhe 75-vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist.

Mëngjesin e të martës së 26 Nëntorit 2019, ndërkohë që shqiptarët përgatiteshin për të përkujtuar 107 vjetorin e Pavarësisë dhe 75-vjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist, një tërmet i tmerrshëm goditi vendin tonë. Ende nuk e dimë përmasën e plotë të dëmeve. Ajo që dimë deri tani është se me dhjetëra shqiptarë kanë humbur tragjikisht jetën nën rrënoja, qindra janë lënduar dhe shtëpitë e tyre janë shkatërruar. Mendimet dhe lutjet tona janë me të lënduarit, me ata që vuajnë dhe me familjet që përjetuan dhimbjen më të madhe, atë të humbjes së njerëzve të tyre të shtrenjtë.

“Në Ditën e Pavarësisë, nga zemra e kombit kullon gjak. Lutjet tona për më

të prekurit. Këto ditë, më të vështirat e viteve të fundit, nxorën më të mirën e njerëzve”, thuhet në deklaratën për shtyp të OBVL. Kryetari i kësaj organizate, kol.ing. Myfit Guxholli ndër të tjera vlerëson shpirtin e bashkuar të shqiptarëve në këto ditë të vështira.

“Në orë e ditë nevojë ne jemi një komb i bashkuar. Shqipëria e vërtetë është ajo njerëzve me zemër dhe forcë të madhe. Në 107 vjetorin e Pavarësisë dhe 75-vjetorin të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist, të bashkuar, të nderojmë kujtimin e atyre që na mori kjo tragjedi”, u shpreh ai.

Familjet e viktimave në Durrës e Thumanë kanë nevojë për solidaritetin tonë në këtë moment të vështirë. Sepse ata kanë nevojë të përbashkëta, një fat të përbashkët dhe një të ardhme të përbashkët.

Ata po përballen me një tragjedi, ndaj më shumë se kurrë kanë nevojë për solidaritetin dhe ndihmën tonë. Sepse kjo mund të ketë të bëjë me shtëpinë ngjitur.

PROFIL

Resul Resulit duhet t'i akordohet titulli "Dëshmor i Atdheut" dhe të nderohet për veprën e tij

DËSHMORËT NË RRËNJËT E LIRISË SË SHQIPTARIZMIT

(Kushtuar luftëtarit fushëbardhas Resul Beqo Resuli/Onjea, (1869–1897), i cili ka rënë për mbrojtjen e truallit arbëror më 1897, në luftën e tretë për mbrojtjen e tokave shqiptare në Vilajetin e Janinës)


Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Shqipëria jonë e shtrenjtë, atje ku flitet shqiptarçe nga brezat arbërorë janë të përbashkuar nga gjaku, gjuha, kultura, flamuri, tradita e besa. Brezat nuk mund të harrojnë kurrë të rënë për tokën arbërore, heroizmin në luftë në mbrojtje të tokës arbërore. Është koha të fshijmë "pluhurin" e harresës sepse ndërgjegjia kombëtare e shoqërore kërkon të memorizojë historinë e kombit të nëpërkëmbur, të sulmuar e të lakmuar, është koha për të rihapur një çështje kaq e munguar prej dhënien e statusit "Dëshmor", sepse që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri më sot kanë rënë në fushëbeteja më shumë se 50 mijë shqiptarë të rënë për liri, pavarësi e demokraci. Në pedestal të kombeve qëndron gjaku i të rënëve, i bijëve që kanë shkruar epope trimërie e guximi, sakrificë, që nuk mund të harrohen. Për këtë arsye luftëtarit Resul Resuli/Onjea dhe gjithë luftëtarëve shqiptarë që gjakun e derdhën për Atdhenë, bazuar në Ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", neni 5 "Kriteret për shpalljen e statusit "Dëshmor i Atdheut"; i cili ka hapur dritën jeshile për dhënien e statusit "Dëshmor i Atdheut" duhet t'i akordohet titulli dëshmor dhe të nderohet për veprën e tij, sikurse gjithë bijtë e kombit shqiptar që gjakun e derdhën për Mëmëdheun, për truallin arbëror. Ky është detyrim i madh i amanetit të brezave për sot si dhe për vitet e dekadat që vijnë, sepse dëshmorët janë amanet i përjetësisë dhe shenjtërisë të të gjithë kombeve.

NË SHQIPËRINË E GJYSHËRVE, KU EMRI PROFETIK "RESUL" RRITEJ E MADHËSHTOHEJ NË BETEJA

Djali i Fushëbardhës Resul Beqo Resuli (Onjea) lindi në trevën labe të Gjirakastrës në vitin 1869. Ishte koha kur vendlindja e tij sikurse gjithë Krahina e Kardhiqit në Labëri e më gjerë vuanin nga sundimi osman. Gojdhëna thotë se, emrin ja vuri gjyshi. E quajti "Resul", me këtë emër profetik, që do të thotë "Profet", sepse të tillë e donte ai, por të tillë e donte edhe koha e misionëve të mëdha. Fëmijëria e tij ishte e vështirë si gjithë moshatarët.

Arsimimi për kohën ishte ishte privilegj vetëm i shtresës së administratës civile e ushtarake osmane, dhe në fakt zhvillohej vetëm në mejtepet në osmanllisht. Por sikurse gjithë fëmijet e të rriturit në atë kohë mësonin vetëm gjuhën e nënës, gjuhës amëtare shqipe, por dhe osmanllisht të nevojshme për kohën sepse cdo lloj dokumentacioni ishte në osmanllisht. Fëmijëria e Resulit shkoi shpejt dhe u burrërua duke mësuar bëmat e të parëve të tij të ardhur nga fshati Vajzë e Vlorës e të vendosur në kodrat pranë Kofolës në kufi me Zhulatin, në Fushëbardhë. Ditët kalonin kodrave, maleve e atyre pak lëndinave e fushave të fshatit, për të siguruar minimalist jetesën, ndërsa në mbrëmje rreth vatrës ushqeheshin me fukarallëkun e kohës, por dhe me frymën e traditës atdhetare, mësonin trimëritë e betejat e lebërve shekujve, për nizamët që koshalet osmanë mobilizonin cdo vit jo pak por 14000 djem ushtarë në të gjithë sanxhaqet/prefekturat e Shqipërisë në



RESUL BEQO RESULI
(1869-1897)

Rumeli. Por për rastet që dovleti lëshonte kushttrim "Vatan koruma için/për mbrojtjen e vatanit" në "harb zamani"/kohë lufte, numri i të mobilizuarve sërish rritej që përfshinte edhe redifët dhe vullnetarët. Resuli kur u rrit në moshë u bë zot i vetes dhe familjes. Erdhi koha e martesës sepse nizamllëku duhej që disa gjëra t'i bëje në kohë, të martoheshe dhe të bëheshe me fëmijë "ishte detyrë", për të siguruar vazhdimësinë. E tillë ishte tradita familjare që kur kishin ardhur në "nomenë e re", në Fushëbardhë, kur ishin vendosur prej Vajzës së Vlorës. Në Fushëbardhë kishin ardhur rreth mesit të viteve 1850, nga katër vëllezër tre prej tyre: Azemi, Asimi dhe Bequa; ndërsa vëllai i katërt Myniri qëndroi në fshatin Vajzë, "për ta mbajtur zjarrin ndezur", në vatanet e të parëve, pasardhësit e degës së të cilit janë sot gjenden në Amerikë dhe në Tiranë. Erdhi dita e dasmës dhe Resul Beqo Resuli/Onjea, u martua në verën e 1890, kur ishte 21 vjeç. Dasma ishte sipas traditës labe me miq e të ftuar të shumtë nga Fushëbardha, krahina e kardhiqit e deri në Vajzë të Vlorës. Shpejt u bë me fëmijë i lindi djali i parë Avdiu në vitin 1892 dhe vajza e tij Simitja që e quajten Simitë në vitin 1895. Edhe pse ishte djalë i vetëm Resuli, ju përgjigj thirrjes "për nizamë", ndërkohë që pas kishte lënë prindërit, bashkëshorten dhe dy fëmijët në moshën pesë e tre vjeçare. U përcooll me shpresë të rikthimit, sepse ishte djalë i vetëm pa vëlla e pa motër. Rënia në fushëbetejë u prit si një gjëmë familjare. Eshtrat nuk ju kthyen por vetëm mandate dhe fermani osman, se ra për vatanin në krye të detyrës. Kaq vlente jeta. Koha kaloi dhe shpejt u rritën fëmijët Avdi Resuli (Onjea) dhe vajza Simitë Resuli (Basho). Jeta rrodhi më tej dhe miqësitë e krushqitë u forcuuan me miqësi të reja, por nuk u harrua as origje Vajzës së Vlorës, që shikohej si "derëbabe", për djemtë e vajzat që rriteshin në fisin Resuli në lagjen fushëbardhase "Onjea".

KUR DJEMTË SHQIPTARË SHKONIN USHTARË PËR PERANDORINË OSMANË

Djemtë shqiptarë sikurse edhe djemtë e Fushëbardhës dhe Labërisë i merrnin askerë dhe i çonin në Skelat shqiptare fillimisht e më tej djemtë i merrte vaporri osman "Daut", që mbushej me të rinj shqiptarë për të bërë shërbimin e detyrueshëm ushtarak 7 vjeçar. Anija "Daut", ishte bërë një emër i njohur për

skelat bregdetare shqiptare sepse conte në kazemat ushtarake të Portës së Lartë "ajkën e djalërisë" shqiptare, në zbatim të "fermanëve" famëkeqe, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me gjak, me zjarr e hekur. Njerëzit në brigjet shqiptare e quanin "Anija e Dhembshurisë", të dhimjes dhe dashurisë, të mallëngjimit dhe shpresës, sepse ndër vendet ku shërbenin arnautët/shqiptarët ishte dhe Jemeni sikurse ishte cdo copë tokë e sulltanatit në 8 milionë km² në tre kontinente. Jemeni njihej veçanërisht nga këngët e popullit: "Ah o Jemen,/trëndafil prej bari,/vallë kush shkon,/pse s'kthehet më për së gjalli?". Në vitin 1896 nga Fushëbardha u mobilizuan disa askerë/ushtarë nga strukturat mobilizuese osmane dhe që u dërguan fillimisht në kazemat e Stambollit. Prej andej katër prej tyre u dërguan në Jemen, ndërmjet të cilëve dhe Resul Resuli. Një ngjarje luftarake detyroi Portën e Lartë dhe Këshillin e Luftës së Osmanëve që të bënte riorganizim forcash. Kështu fushëbardhasit u rikthyen pas disa muajsh sepse kishte shpërthyer lëvizja për ishullin e Kretës, të njohur në zonën greke. Askerët u afruan me anije për të qenë të gatshëm për mbrojtjen e ishullit, që historia e njeh si "lufta greko-osmane për çështjen e Kretës". Kronologjikisht ngjarjet luftarake zhvilloheshin në atë që njihet si "Lufta e tretë për Vilajetin e Janinës" të 1897-tës, ku në plan të parë del dhe vorbulla e madhe e lakmive ballkani-ke, një stacion lufte që për shqiptarët dhe çështjen shqiptare dëmtimi i tokave të perandorisë në këtë periudhë ishte humbje për truallin shqiptar. Në mars 1897 gjendja në hapësirën shqiptare u acarua dhe më shumë. Pjesa jugore e Shqipërisë rrezikohej nga forcat greke, por edhe nga ndërhyrja e shteteve të tjera të Ballkanit, Serbisë e Bullgarisë. Trupat greke ishin në kufijtë e Thesalisë të vilajetit të Janinës, ndërkohë që luftonin për Kretën. Në vilajetin e Janinës, udhëheqësit e lëvizjes kombëtare dhe shumica e parisë shqiptare nuk pranuan t'i jepnin Sulltanatit ushtarë se do t'i ruanin forcat për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë. Grekët nuk patën sukses për pushtimin e Kretës në mesin e shkurtit të 1897. Greqia e shtriu luftën në Thesali dhe në vilajetin e Janinës, ku sulmoi forcat osmane më 12.4.1897. Sulltanati luftën kundër Greqisë e paraqiste si luftë për mbrojtjen e teritorëve shqiptare. Atdhetarët shqiptarë, udhëheqës të lëvizjes kombëtare, përballë rrezikut të pushtimit të Shqipërisë së Jugut nga Greqia, u detyruan të ndryshonin qëndrimin dhe ta përballonin me forcat e tyre agresionin grek.

Gazeta "Shqipëria" e Bukureshtit shkruante: "Në fillim të luftës greko-osmane, kur grekët luftonin për Kretën, për ta bashkuar ose për autonominë e saj, shqiptarët, të krishterë e myslimanë, simpatizuan luftën e grekëve dhe deklaruan se nuk i japin Sulltanatit ushtarë për luftën. Por, kur Greqia donte të rrëmbente Maqedoninë e Epirin, domethënë Shqipërinë, simpatitë u kthyen në zemërim, dhe "...u lëshuan të mbrojnë mëmëdheun e tyre". Porta e Lartë, premtoi tituj, shpërblime e privilegje në administrimin e vendit dhe bëri për vete parinë shqiptare si dhe siguroi mobilizimin e forcave "vullnetare" shqiptare, që u hodhën në luftë kundër ushtrisë greke në kufirin jugor të Shqipërisë, në vilajetin e Janinës. Ushtria greke pësoi disfatë të rëndë në frontin e Janinës dhe u shpartallua plotësisht në tri javë në një luftë të përgjakshme. Lufta pati edhe të

rënë të shumtë si ushtarë edhe vullnetarë shqiptarë. Pothuaj luftatarët osmanë në shumicën dërmuese ishin ushtarë nizamë shqiptarë, të cilët ishin të bindur në mbrojtjen e truallit arbëror.

KËNGA QË U SHKRUA DHE U KËNDUA QË NË LUFTË NË VILAJETIN E JANINËS DHE NË LABËRI

Ndër djemtë e Fushëbardhës që luftoi dhe u vra trimërisht për Vilajetin e Janinës ishte dhe Resul Beqo Resuli 28 vjeçar, që ra në fushëbetejë në pranverën e 1897-ës, babai i dy fëmijëve. Trupin nuk ja çuan në vendlindje në Fushëbardhë, por sollën vetëm "fermanin-mandatë", me fjalët: "Shehit, rënë për vatanin!". Shokët e tij bashkëluftëtarë përpara se të vinte mandati sollën këngën, që ishte "Autobiografia" më domethënëse e të rënëve, e dokumentuar me gjakun dhe "arkivin-këngë". Ata trima fushëbardhas që mbetën gjallë dhe mbuluan shokët në Janinë, sollën më të papërsëritshmen, këngën labe që kënduan në Stamboll, në Jemen dhe në Janinë, që edhe sot e kësaj dite pas 122 vjetësh na shërben si një "arkiv gjigand" trimërie, me fonde-arkivore, që shkruajnë e dokumentojnë lavdinë e shqiptarëve. Kënga që erdhi nga qendra e Vilajetit të Janinës që u këndua brez pas brezi thotë: "Fushëbardhë t'u rritën djemtë/Të luftojnë për dovet, /Djalë i vetëm pa vëlla, /Luftove me pashallarë/Resul Beqo djalë i rrallë/Gjakun derdhe për vatanë, /O Janinë, Janinë xhani,/Del se të kërkon junari,/Të të ndajë nga vatani, /Nuk më lënë djemtë levendë,/Që plumbin presin në këmbë...". Kjo është kënga që që lindi në xhephane lufte, u dokumentua dhe u shkrua në "arkivin-këngë" të historisë dhe u këndua në gjithë Labërinë. Prandaj ka marrë me vete pavdekësinë, meriton nderim në altarin e burrave të kombit. Është pikërisht kjo këngë që më së shumti u këndua në dy fshatra të Labërisë në Fushëbardhë, por dhe në Vajzë të Vlorës në origjinë e familjes "Resuli/Onjea". Resul Beqo Resuli/Onjea, e derdhi gjakun për truallin shqiptar dhe meriton nderimin e respektin e brezave sikurse e meriton cdo luftëtar shqiptar që gjakun se kurseu me idealin e madh: "Për Mëmëdhenë". I tillë ishte "fati" shqiptar për 4-5 shekuj para 1912-tës, që jetën jepnin për shërbim të Perandorisë. Fakt është se me ndërhyrjen e Rusisë dhe të Fuqive të tjera të Mëdha, trupat osmane bashkë me repartet vullnetare shqiptare, e ndalën përparimin e tyre. Më 19 maj 1897, u nënshkrua armëpushimi ndërmjet Sulltanatit Osman dhe Greqisë dhe më 4 dhjetor 1897 nënshkroi Traktatin përfundimtar të Paqes. Edhe pse doli fitimtare, Perandoria Osmane, sipas marrëveshjes me Shtetet e Mëdha evropiane, e humbi Kretën, e cila u shpall "autonome" dhe "asnjanëse", nën kontrollin e Fuqive të Mëdha. Gjaku i Resul Beqo Resulit/Onjea dhe shokëve të tij rrodhi për truallin e lirë shqiptar, pa i ditur dhe pa i njohur konjunkturën e pabesitë e kohës. Ai e derdhi gjakun një dekadë e gjysëm përpara se Ismail Bej Qemali të shpallte pavarësinë shqiptare më 28 nëntor 1912.

Por djemtë që shkonin në roje të Vilajetit të Janinës, shkonin të luftonin me bindje të plotë në mbrojtje të së drejtës së tyre kombëtare, në mbrojtje të familjes, fshatit, krahinës, gjuhës, kulturës e territorit shqiptar. Djelmoshat shqiptarë që pavarësisht uniformës, formacioneve ku bënin pjesë, armatimit dhe kundërshtarit përballë kishin një ideal, Shqipërinë e lirë, të jetonin të lirë në truallin e tyre amëtar.

KRONIKA



75-vjetori i Çlirimit/ Konferencë ndërkombëtare nga Akademia e Shkencave

Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore

Klotilda Saraçini

TIRANË, 14 nëntor /ATSH/ – “Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore” titullohej konferenca shkencore ndërkombëtare e organizuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë.

Në këtë konferencë ishin të pranishëm, kryetari i ASHSH-së, Skënder Gjinushi, Kryetarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Floresha Dado, Prof. Roderick Bailey, prof. Hamit Kaba, prof. asoc. Sabit Syla, prof. Prof. Hamit Kaba, akademiku Bernd Fischer (SHBA), prof. Federico Goddi (Itali), etj. Ishin të pranishëm gjithashtu si të ftuar: Kryetari i OBVL kol. Ing. Myfit Guxholli, Nënkryetari i OVLANÇ të Kosovës Vashkim Hisari, Sekretari i Përgjithshëm i OBVL Halil Rama, dhe anëtar i Kryesisë së OBVL Sakip Cami.

Në fjalën e tij, kryetari Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi theksoi se “konferenca e sotme është aktiviteti më i rëndësishëm për këtë vit i Akademisë së Shkencave, sepse nuk ka të bëjë thjesht me një aspekt të veçantë apo temë shkencore! Sepse nuk është moment që kujtohet në intervale periudhash të gjata! Sepse nuk është çështje që i përket thjesht dhe vetëm një rrethi të ngushtë njerëzish! Sepse është ngjarja rreth së cilës në tre dhjetë vjeçarë është shkruar e diskutuar më shumë”.

“Një jubile i madh mund të nderohet në mënyra të ndryshme. Dhe kremtimi shkencor i këtij jubileu lidhet me parime themelore metodologjike të qasjes ndaj objektit shkencor. Akademia e Shkencave ka detyrimin shkencor të thërrasë për këtë interpretim dhe vlerësim të gjithë historianët që e duan dinjitetin e vendit, ndonëse mund të kenë edhe mospajtim në tezat e tyre. Ne nuk mund ta lemë këtë temë themelore të historisë peng të medias, të opinionëve të njerëzve që nuk kanë lidhje me thelbin e historisë”, – nënvizoi Gjinushi.

Prandaj, vijoi Gjinushi, në kremtimin e këtij jubileu të madh për herë të parë



iu bë thirrje e hapur studiuesve për kontribute shkencore, duke dëshmuar se në parimet tona nuk ekziston skajshmëri, por përfshirje e specialistëve të periudhës për të vlerësuar dhe sjellë fakte të reja për një nga periudhat më të ndritura të rezistencës shqiptare ndaj pushtimit nazifashist.

“Sigurisht, ju e dini më mirë se kushdo, që historiografia jonë vazhdon të ketë probleme, që vinë nga tre faktorë: 1. kompleksiteti i periudhës ‘39-’44, me lëvizjet e brendshme dhe të jashtme që karakterizuan atë; 2. Pamundësia e njohjes së plotë të dokumenteve dhe pushtetit ideologjik në studimet e para 90-ës; 3. Mundësitë e pakufizuara sot të gjetjes së dokumenteve të reja, të kuptimit më të gjerë të periudhës në specifikat e brendshme dhe të jashtme të saj”, – theksoi Gjinushi duke shtuar se këta faktorë sigurisht e kanë komplikuar punën.

Por, shtoi ai, është rasti të shpreh keqardhjen ndaj çdo lloj qëndrimi ekstrem, mohues për një ngjarje kaq madhore në historinë e shqiptarëve, të cilët u renditën me dinjitet në krahun e fitores botërore. “Kjo është një krenari e të gjithë historianëve, është një motiv i madh që nuk duhet të përplasë studiuesit, por që vetëm jep shtysën për të zgjeruar njohjen mbi një periudhë që pati kompleksitetet e veta”, tha Gjinushi.

REPLIKA

SHBA & NATO mbeten jetike për sigurinë dhe vlerat Euroatlantike

Gjeneral Piro AHMETAJ

Pndaj “këndveshtrimet dhe kundërshtitë profesionale” në lidhje me deklaratën “bombastike” të Presidentit Macron: “NATO po përjeton vdekje klinike dhe BE duhet të rimarrë sovranitetin ushtarak”.

Nuk është e para herë në 70 vjet histori suksesi të NATO-s (si Aleanca më e fuqishme e historisë së njerëzimit dhe vlerave Euroatlantike), as e fundit dhe as një zë i vetmuar nga brenda NATO-s.

Veçanërisht mbas viteve 1991, mbasi ishte “shkërmoqur” Traktati i Varshavës (i cili u krijua 6 vjet mbas themelimit të NATO-s (1955), aktorë, faktorë, strategë dhe oponentë të vijës së parë nga kontinenti evropian, “nxitimthi” shtruan pyetjen: “misioni u KRY, pse na duhet NATO”?

Ndërkohë, vetëm për ekspertët/kolegët shtoj se, BE nëpërmjet disa marrëveshjeve (Berlin++) ka ngritur dhe përditësuar arkitekturën politike dhe ushtarake (ESDP/Mil.Com/PESCO), etj.

Por, me gjithë ambicjet, “idetë brilante/populiste” dhe përpjekjet, ende nuk ka një përgjigje: “BE është konkurrese apo komplementare me NATO-n në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”.

Edhe më e thjeshtë, për mijëra e mijëra bilionë euro/dollarë, mbetet: “A mundet BE të ngrejë kapacitete për tu “vete-mbrojtur pa fuqinë ushtarake të SHBA nga kërcenimet referuar artikullit 5”?

Mos të bëjmë naivën për të ushqyer “populizmat anti-amerikanë”, që në Shqipëri u bënë edhe më qesharake nga “citaret” e diktatorit të rrjedhur Enver Hoxha, si “rezi-ku anglo-amerikan”.

Besoj fort, se përgjigjen e dinë të gjithë, përfshi edhe Presidenti Macron! Historia na kthen në rrethanat e përgjakshme të para-Luftës së II-të, kur pothuaj të gjitha vendet e BE, përpiqeshin të bënin “mbi-nën dhe”, marrëveshje me Hitlerin, duke ëndërruar “se vendi tyre s’do të prekej ose të “merrnin premtimin”, se Ai si, ciklopi do i u bënte nder se “do ti hante të fundit ...”.

Kreu i Akademisë së Shkencave u shpreh se “e kuptoj që zbulimi i dokumenteve të reja, interpretimi i tyre në logjikën e historicizmit, pa fshetur e pa zbuluar asgjë, është detyra e studiuesve, por shkencë nuk do të thotë të përmbysësh nisur nga motive politike, por t’i japësh kuptim së vërtetës”.

“Konferenca e sotme është më e gjera, që është organizuar deri sot për fitoren e luftës antifashiste, si në tematikë, ashtu dhe në përfaqësim të studiuesve të huaj dhe shqiptarë nga SHBA, Anglia, Italia, Zvicra, Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Të gjithë janë ftuar për të sjellë kontribute të reja. Është krejt normale që ju studiues të nderuar të keni teza vetjake, që edhe mund të mos përputhen me të tjerëve. Kjo është shkenca. Kjo është ajo që e dallon një konferencë të Akademisë së Shkencave nga tubimet festive”, – tha Gjinushi.

Ai shprehu bindjen se konferenca do jetë modeli i vlerësimit të kësaj



Kështu, do doja dhe uroja të isha gabim, por në analizën strategjike, këto qasje “të forta” më dalin të përafërta në mos njësoj prapagandistike: “të rrisin popullaritetin duke frymëzuar patriotët e rinjë, me lavdinë dhe ambicjet e vjetra të Francës”. Besoj dhe uroj të jetë vetëm kaq!

Prandaj, ri-kujtoj se, mbase jo fare rastësisht, përsëri nga Presidenti Charles de Gaulle, i cili në 1966, “vetë- ngriu” statusin e pjesëmarrjes së Francës në Strukturën e Integruar Ushtarake të NATO, për plotë 42 vjet (1966 - 2009)!

Sigurisht, kjo deklaratë, kërkon një analizë shumë dimensionale, dhe do ishte qesharake vetëm të pretendoj se kjo do mundet të bëhej me vetëm një status në facebook. Ndërsa për mbarë-Kombin tonë (me dy shtete) dhe rajonin, historia e largët dhe e afërt, “Ulëret fort nga mirënjohja”, se: “SHBA dhe NATO mbeten jetike për paqen, sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin, edhe për 107 vitet që vijnë”. Gjithsesi, përtej modesisë së tepëruar, si ekspert “rritur profesionalisht 25 vjet në NATO”, shpresoj të kontribuojë sadopak, për të qartësuar dhe shmangur “çoroditejn e opinin publik”, mbarëKombëtar, në rajon, NATO, dhe jo vetëm.

ngjarjeje nga më të ndriturat në historinë e shqiptarëve, shembull i debatit mirëkuptues, duke projektuar një standard tjetër shkencor për sot dhe më tej, për shumë çështje të tjera për të cilat do të mblihdemi përsëri në këtë sallë, që mban emrin e një shkencëtari të shquar të historiografisë shqiptare.

Në konferencë u mbajtën disa kumtesa nga akademikët e njohur si; prof. asoc. Sabit Syla (Kosovë), me kumtesën “Kosova ndërmjet Fuqive të Boshtit dhe aleatëve të mëdhenj perëndimorë”, prof. Federico Goddi (Itali), me kumtesën: “An Ephemeral Fascist Dream: Neë Perspectives on Italian Protectorate of Albania (1939-1943), Prof. Irakli Koçollari (Tiranë), me kumtesën: “Shërbimi Sekret Britanik në Luftën e Dytë Botërore dhe raportet e tij me formacionet politike shqiptare për rezistencë e luftë kundër pushtuesve nazifashistë”, akademiku Bernd Fischer (SHBA), me kumtesën: “Results of the Partisan Victory in Albania – the American View”, etj.

PROMOVIMI

Studjuesi Xhemal Meçi – “Mjeshtër i Madh” promovon një nga kryeveprat e tij

“Sofra Pukjane” në promovimin e librit “KOMANI-Ana e Drinit, Delmace, Pukë

Prof. dr. Bajram XHAFA

Dita e vrenjtur dhe me një shi të herëpashershëm e prish pak humorin por, kur pamë ndryshimin qendrës së qytetit, pata një befasi të këndshme. Sheshi i qytetit përpara Pallatit të Kulturës dhe Pedonalja si zgjatim e tij deri para Turizmit me dy rreshta dritash mbi shandanë të lartë hekur të rreshtuara në një kolonë dhe pllakat e mermerit të shtruar drejtë, e alternuara me ngjyra të ndryshme, i kishin rrafshuar ondulacionet e relievit të trashëguara nga kapriçiot e natyrës. Ndriçimi i pllakave dhe drita e fasadave të pallateve, gjelbërimi shumëngjyrësh i gjetheve të drurëve dekorativ i paskan dhënë Pukës pamjen e një qyteti malor të kultivuar hijshëm. Kështu, Puka e sotme me kurorën e në reliev të përthyerë të Alpeve nga veriu, e futnin Pukën në vargun e qyteteve tona alpine turistike, aq sa me ia pasë zili (!).

Urime dhe bekime Bashkisë së Pukës dhe “Sofrës bujare Pukjane” që me “Akademinë” informale, por funksionale të Pukës, që me botimet e Profesor Xhemal Meçit e ngritën edhe një kat tjetër “murin e librave” “PUKA QË NË LASHTËSI - 7”. Shqiptarët më së shumti e masin mirësinë me “bukën e shtrume”. Shpesh them me vete: sa sofrat janë shtruar në Pukë dhe sa bukën e tyre kam ngrënë atje?! Nuk numërohen. Jam ba i sh(të)pisë, byr-azer e vëlla pa hise, siç e thot Kanuja e Lekë Dukagjiti, Varianti i Pukës, (Shkodër, 2019). Sofra në Pukë e përtej Pukës në promovimet e librave të Xhemal Meçit duke filluar me librin “Puka që në lashtësi”, me “Kanuni i Lekë Dukagjinit” (varianti i Pukës e varianti i Mirditës), dy promovimet për Prendush Gegën, (“Poeti i Malësisë - Puka që në lashtësi - 5” dhe “Poeti i Kabashit - Puka që në lashtësi 6”), “Flutura shpirti i Allamanit” të Sefer Pashës (8 qershor 2014), me rastin e 10 vjetorit të rënies së dëshmorit pukjan të policisë Allaman Dervishi; për “FRANG BARDHI e PUKA” me rastin e 380 vjetorit të vizitës së Tij apostolike në viset e Pukës (5-20 qershor 1637), për “Migjenin në Pukë”, etj. etj. Por, sofrat edhe në Kryezi, kuptohet, për Gjeçovin, vendorigjinën e tij; edhe në Kabash të Prizrenit për veprën “KABASHI” (“Puka që në lashtësi - 2”), edhe në Zym të Hasit (Prizren, 12-14 tetor 2017), përsëri për Shtjefen Gjeçovin, në kujtim të martirizimit të priftit atdhetar (më 14 tetor 1929) nga shërbimet e fshehta armiqësore serbe, që simbolizon gjithë martirizimin e katolicizmit shqiptar të shkaktuar nga serbo-sllavizmi qysh nga koha e Stefan Dushanit.

Sofër edhe në Fushë-Arrës (Hadroj), ku nuk harrohet impresioni që shkaktoi me vallen që hoqi gjithë gjallëri e stil (pogonishte a devolliçe) Sefer Pasha, mallakastrioti, mik i Pukës dhe i pukjanëve; madje, sofër edhe në Shkodër e Tiranë; gjithkund, për promovim



librash të Xhemal Meçit, në “bukë të Pukës”. Dhe tani së shpejti në Tiranë, në “bukë” të biznesmenit bujar e human, të nderuarit Kadri Morina, me origjinë nga Malziu i Pukës për promovimin e librave binjakë Shkodër 2019, KOMANI... DELMACE PUKË, TRASHËGIMI ILIRO-ARBËRORE dhe Botimi i Dytë, KANUNI i Lekë Dukagjinit, Varianti i PUKËS, Puka që në lashtësi -8.

Ka dhe të tjera sofrat në Pukë. Është ligj i biznesit, egoja dhe konkurrenca e egër, por biznesmenët e Pukës janë të veçantë: me biznesin e tyre ata edhe e ndajnë bukën dhe forcojnë vëllazërinë. E duan Pukën. Shohin nga e ardhmja por nuk e harrojnë të kaluarën e saj etno-historike, traditat, kulturën e tyre, këngët dhe vallet e tyre, folklorin e tyre aq gjallërues e optimist. Pra, e duan historinë dhe shkencën, bëjnë për të dhe, nuk kursejnë për të.

Më të shumtat e promovimeve, thashë, lidhen me punën e “profesorit” Meçi (kështu e thërrasin të gjithë në Pukë, por edhe në Shkodër e në mjaft raste në Tiranë dhe Prishtinë, që siç reçitoi në poezinë e tij rapsodi Vitor Paloka i VADEJËS: “Xhemal Meçi – “Profesor” edhe pse pa “letra”, por “profesor” me vepra, me librat e tij, me miqësinë e miqtë e tij të shumtë, që u bënë edhe miqtë tanë nga Puka, Tirana, Kukësi, Shkodra, Kosova etj. Një kolanë e tërë librash për PUKËN, si fjala vjen, për librin “Aliajt e Kryeziut (Pukë) paraardhës të Gjeçovit” me autor Tonin Alia; apo “NË PANTEONIN E LIRISË” të inxh. Kolë Dedaj etj. Unë prapë, pak fjalë i rezervoj për Profesorin, se vepra e tij flet vetë.

Nuk pushon ai, e nuk e meh punën.

Ashtu, i përvuajtur, burrë i gjerë e mundqar, plot durim e ngulm, vit pas viti rreshtoi ai njëra pas tjetres mbi 10 veprat e tij, me numër serie mbi kapak. Burrë me vokacion të lartë e të thellë. Gjithë jetën punoi e punon si spartan dhe idealist. Punë mbi punë. Ka kohë që ka dalë në pension profesori, por pensioni nuk është për të pushim, për të gëzuar qetësinë, prehjen e pleqërinë në rehati, por “profesor” Meçi nuk don rehati e nuk njeh pushim. Tek puna ka kuptimin e gëzimit e jetës. Mbipuna tek ai është më e madhe se puna zyrtare, ajo e mësuesit, e nominuara. Më e madhe vepra nga puna e paguar se nga puna që i është “paguar”. Përsëris: një punonjës shkencor efektiv në Institutin e Kulturës Popullore, ku ai ishte si i jashtëm, do ta kishte zili prodhimtarinë e tij. Por, këto, sigurisht, nuk kalojnë pa pasoja. Një jetë plotë mundime si dhe mbi 80 vite mbi kurriz, e shpunë në spital profesorin para dy vitesh, ashtu siç kishte ngjarë disaherë edhe më parë. Iu lut mjekëve ta shpëtojnë jo për hatër të jetës së tij, por, për vocrrakë që ka me rritë. Për librat në dorëshkrim që presin t’u jepte “përdafin” e fundit për ta përmbyllur vargun e gjatë të botimeve. Përndryshe, ajo punë e akumuluar gjatë jetës e nisur që nga viti 1955 me ekspeditat e tia në Koman. Meqenëse lutja shprehte përkushtimin fisnik ndaj punës, puna është ibadet, Zoti i Madh ia pranoi lutjen dhe sot Puka dhe shkenca e Etnologjisë ka në dorë një tjetër libër të tij: “KOMANI - Ana e Drinit-Delmace, trashëgimi iliro-arbërore” “Puka që në lashtësi 7” së bashku me Kanunin e Lekë Dukagjinit, Varianti i Pukës, Botimi i Dytë (Shkodër, 2019)

Librat e tij janë në hullinë e arritjeve më të mira të shkencës së historiografisë dhe arkeologjisë mesjetare shqiptare, si nyja kryesore që lidh e bashkon racën shqiptare, pararendëse dhe pasrendëse, ilirët me arbërit në një vazhdimësi historike për t’i prurë tek shqiptarët e sotëm. Një studim i Meçit për Komanin, atij Komani me emër simbol që i ka dhënë pagëzimin një kulture të tërë për një periudhë kyçe të historisë: “Kultura e Komanit” Në Pukë prof. Xhemalit Zoti i dha jetën dhe gëzimet e saj. Puka dhe pukjanët, por edhe e gjithë shkenca dhe kultura shqiptare që e ka vlerësuar e duhet ta vlerësojnë e ta peshojë këtë kontribut.

Ibrahim Sokoli, vëllau i Ramadan Sokolit, muzikologut të famshëm shkodran, tregonte një gjëzë për një gjakovar: “Shumë kohë më parë, tek po përcillte me qetësi vitet e pleqërisë dhe duke menduar se tashmë nuk i kishin mbetur në dispozicion të kësaj dynjaje aq ditë sa ç’kishte kaluar vite, ky plak nga Gjakova i paska thënë: “60 Ramazanë i agjërova, 120 Bajrama (të Madhin e të Voglin) i festova, bile tuj qitë pushkë (me solemnitë); 500 groshë (shumë e madhe për atë kohë) ia kam lënë Tyrbes së Becit, 500 groshë të tjera kishës së Deçanit. Në mos shkofsha kësaj radhe edhe unë në xhenet, këtu një hile asht.”(!!!) Kështu edhe Xhemali! Besoj se nuk i ka lënë kusur punës shkencore e profesionale. Ibadetet e kësaj dynjaje para Zotit besoj se i ka kryer. Besoj se edhe shoqëria, institucionet, komuniteti e ka çmuar dhe do ta vlerësojë e ta çmojë këtë pasuri që po u le dhe që shpresojmë (në dashtë Zoti) se do bëjë edhe të tjera.

JUBILARE

Me respekt dhe krenari më të lartë u kujtuan sakrificat e dëshmorëve të lirisë, heronjtë e veteranët e LANÇ dhe kontributi i luftëtarëve të UÇK-së për lirinë e Kosovës

75 VJET MË PARË U ÇLIRUA GJAKOVA

- **Zija Mulhaxha:** “Eshtnorja Përkujtimore në Çabrat, ku janë eshtrat e dëshmorëve të rënë në LANÇ e cila me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës u emërtua me emrin heroit të popullit Fadil Hoxha, është respekt dhe mirënjohje për krejt at që ka bërë Fadil Hoxha, për lirinë që gëzojmë sot”
- **Skender Hoxha:** Fadil Hoxhën ishte dhe do të mbetet në historin tonë së një nga figurat më të shquara i cili ndër të parët përqafoi idet përparimtare lirisdashëse të kohës
- **Lek Hoxha:** Pa angazhimin, sakrificën, patriotizmin, kontributin e veteranëve të LANÇ, për liri, shkollimin e kuadrove, nuk do të arrinim dot të ruajmë kufijtë, dhe UÇK-ja të çliroj Kosovën nga Serbia e të ndërtohet Kosova – shtet sovran dhe i pavarur.
- **Nazmije Duraku-Peja:** “U shkëputën nga zemrat tona, por kur dijmë se ata ishin të gjithëve, dhimbja na u shëndrua në forcë. Me këtë forcë u ndërtua kështjella e pavarësisë që gurëthemel ka gjakun e heronjëve dhe dëshmorëve të LANÇ”.

Nga Bashkim Hisari

Në vitin jubilar të 75-vjetorit të fitorës ndaj nazifashizmit, në Gjakovë u shënuar Dita e çlirimit të qytetit me rrethin dhe formimi i Brigadës VII sulmuese e cila u krijua me qëllim për të mbrojtur lirinë, traditën, për të mobilizuar e nxitur popullin e Kosovës të marrin pjesë në luftë kundër nazistëve gjerman dhe të bashkohen Aleancës së popujëve për çlirimin e vëndit për ta fituar të drejtën për vetëvendosje pas luftës.

Në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ), gjakovarët dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Mbi 100 gjakovarë ranë dëshmor, 45 ishin viktimat të terrorit fashist, 41 bartës të përkujtimeve partizane 1941 dhe 9 janë shpallur heronjë të popullit.

Shënimi i këtyre ngjarjeve të rëndësishme historike të kombit tone, bëri bashkë veteranët e LANÇ, pasardhësit e tyre dhe familjarët e dëshmorëve nga Gjakova, Prishtina, Prizreni, Peja, Vitija dhe të tjerët që antifashizmin dhe fitoren në Luftën e Dytë Botërore konsiderojnë si gjën më të shenjtë dhe më të lavdishme të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Bashkarisht, ata bënë homazhe dhe vendosën kurora dhe tufa lulesh në bustet

e heronjëve të cilët luftuan dhe flijuan pjesën më të bukur të jetës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Fillimisht, u nderua dhe u përkujtua jeta dhe vepra e heroit të popullit Emin Duraku. Me homazhe u nderuan edhe heronjtë e popullit Asim Vokshi, Hajdar Dushi, Mustafa Bakija dhe Sadik Stavileci. Pranë bustave të tyre u vendosën kurora dhe tufa me lule.

Në Eshtnorën Përkujtimore në Çabrat, ku janë eshtrat e dëshmorëve të rënë në LANÇ e cila me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës u emërtua me emrin heroit të popullit Fadil Hoxha, foli kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Zija Mulhaxha i cili përshëndeti këtë vendim dhe tha: “Respekt dhe mirënjohje për krejt at që ka bërë Fadil Hoxha, për përkushtimin e tij për lirinë që gëzojmë sot. Na vjen mirë që Kuvendi i komunës së Gjakovës ka marrë përsipër ta restauroj, ta renovojë dhe ta shpallë këtë Eshtnore si monument i cili ka me përkujtu luftën e gjeneratave të shqiptarëve për liri, pavarësi, për



luftë kundër okupatorit dhe për çlirimin e vëndit”. Ndërkaq, në varrezat e qytetit pjesëmarrësit bënë homazhe dhe pranë varrezave të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) vendosën tufa me lule. Në shenjë nderimi për sakrificat dhe gjakun e të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës ata qëndruan me një minutë heshtje.

Po në varrezat e qytetit pjesëmarrësit u përkulën, nderuan dhe vendosën kurora dhe tufa me lule tek varri i heroit të popullit Fadil Hoxha dhe të ish kryetares së Shoqatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës Vahide Hoxha.

Duke folur në këtë festë jubilarë të 75 vjetorit të fitorës ndaj nazifashizmit dhe çlirimit të Gjakovës, kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Dega në Gjakovë Skender Hoxha foli për rolin e këtij qyteti si një qendër e rëndësishme e lëvizjes antifashiste e në kuadër të kësaj edhe për meritat e heroit të popullit Fadil Hoxha në krijimin e Ushtrisë dhe për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit nazistë. Me këtë rast ai ndër tjera tha: “Dita e çlirimit është një datë historike, një ditë krenarie për të gjithë qytetarët e Gjakovës me rrethinë. Kombi shqiptar ka mbijetuar në shekuj duke i mbrojtur vlerat, kulturën, vërtetet e tij e kur e deshti nevoja, ka derdhur edhe gjak për liri. Në LANÇ morrën pjes më se 53.000 kosovar prej të cilëve 6.200 ranë dëshmor”. Ai theksoi se përkujtimi i ngjarjeve të rëndësishme, nuk është vetëm një përkujtim i thjeshtë për të kaluarën, por para së gjithash, është një moment reflektimi dhe shprehje e konsideratës dhe homazhit ndaj përpjekjeve dhe sakrificave të mëdha të popullit tone i cili me luftën e tij dhe rreshtimin me kohë në anën e Koalicionit Antifashist bëri zgjedhjen më të mirë duke mbetur pjesë e fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore dhe shtoi: “Sot kujtojmë me respekt e nderim të veçantë burrin e shquar të Kosovës dhe gjithë kombit tone Fadil Hoxhën i cili do të mbetet në historin tonë së një nga figurat më të shquara. Fadil Hoxha ishte ndër të parët që përqafoi idet përparimtare lirisdashëse të kohës dhe bashkë me luftëtarët e tij duke kaluar vështërsi të jashtëzakonshme arritën të shkëpusin pjesën e

mashtuar të popullatës së Kosovës nga nazifashizmi dhe të radhiten në frontin antifashist”, u shpreh kryetari i organizatës së veteranëve të Gjakovës.

Ndërsa, nënkryetar i OVLANÇ të Kosovës, Lek Hoxha tha: “shoqëria e jonë nuk mund të ndërtohet, të përparon dhe të demokratizohet nëse nuk çmohen dhe ruhen vlerat heroike e veteranëve të LANÇ që zhvilluan në luftën kundër okupatorit në Luftën e Dytë Botërore. Ideat e tyre ishin antifashizmi, liria dhe vetëvendosje për popullin e Kosovës. Misioni historik i tyre arriti objektivat themelore strategjike. Dolën fitimtar, çliruan vëndin dhe trasuan rrugën për lirinë e kombit tonë. Pa angazhimin, sakrificën, patriotizmin, kontributin e tyre për shkollimin e kuadrove, nuk do të arrinim dot të ruajmë kufijtë, që UÇK-ja të çliroj Kosovën nga Serbia dhe të ndërtoi Kosovën – shtet sovran dhe të pavarur.

Pranë bustit të heroit të popullit Emin Duraku, në qendër të Gjakovës, foli Nazmije Duraku-Peja, motra e Emin Duraku e cila tha se emri i Emin Durakut shkëlqen në të dy anët e shqiptarëve, në Kosovë e Shqipëri, sepse lufta dhe ideali i tij ishin si një thirrje dhe kushtim për gjithë shqiptarët që të realizojnë ëndërn e madhe që kishin partizanët-të arrijnë që të shohin Kosovën dhe Shqipërinë e lirë, sovran dhe të pavarur. Duke folur me plot emocione për vëllain i cili jetoi luftën por jo edhe paqën, ajo tha: “Sot jemi krushqit e martirëve tonë, krushqit e Gjakovës së kuqe e të Kosovës kreshnike, të cilët për nuse e deshtën lirinë e për këtë flijuan atë më të shtrenjtin. U shkëputën nga zemrat tona, por kur dijmë se ata ishin të gjithëve, dhimbja na u shëndrua në forcë. Me këtë forcë u ndërtua kështjella e pavarësisë që gurëthemel ka gjakun e heronjëve dhe dëshmorëve të LANÇ”.

E përbashkëta e të gjitha aktiviteteve me rastin e 75 vjetorit të çlirimit të Gjakovës me rrethin, ishte mesazhi se gjenerata e reja duhet të tregojnë më shumë respekt dhe të nderojnë sakrificën dhe vlerat e dëshmorëve dhe luftëtarëve antifashistë, ideali i të cilëve ishte lufta për atdheun përkushtimi ndaj kombit, liria dhe pavarësia e Kosovës.

HISTORIA

MALESIA E GJAKOVËS - TROPOJA NË LUFTËN ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE (1939-1945)

Ismet Balaj

Edhe populli i Malësisë së Gjakovës-Tropojës e priti me urrejtje të thellë e me shqetësim të madh pushtimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste më 7 Prill 1939. Në ditët e para të prillit, kur u mor vesh se Italia fashiste do ta pushtonte vendin tonë, kudo shpërthyen protesta të fuqishme. Në qendër të nën-prefekturës mbledheshin për ditë qindra malësorë, të cilët protestonin me parulla: "Poshtë Italia Fashiste", "Rroftë Liria", "Rroftë Shqipëria", "Duam armë", "Duam armë". Qeveritarët vendor e qendror heshtën. Mbreti dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë u arratisën jashtë shtetit. Shqiptarët mbetën pa prijës, të çoroditur, të çorganizuar. Qëndresa e shqiptarëve në portet Durrës, Vlorë, Sarandë, Shëngjin që e fortë, por fashistët kishin marrë masa të gjithanshme dhe arritën t'i pushtonin, pastaj edhe gjithë Shqipërinë..

NJËSITET E PARA DHE ÇETA E MALËSISË KUNDËR FASHIZMIT

Nga protestat dhe demonstratat, deri te njësitet e armatosura kundër pushtuesve, kaluan më se dy vjet. Gjatë kësaj periudhe u bënë disa aksione individuale. Këtë ngadalësim e kanë shkaktuar faktorë të shumtë të brendshëm e të jashtëm. Po shumë ndikuan faktorët ndërkombëtar ku mbizotëronte ideja se Boshti Romë-Berlin-Tokio është i pathyeshëm. Paria mbajti qëndrim pajtues ose u vu në shërbim të italianëve. Lëvizja dhe lufta antifashiste nacionalçlirimtare edhe në rrethin e Tropojës u organizua nga poshtë. Duhet kuptuar se nuk ka qenë kjo periudhë paradë suksesesh, por ndeshesh shumë të ashpra mendimesh, të kundërta që çonin në edhe në ballafaqim me armë.

Në korrik të vitit 1941 Grupi Komunist i Shkodrës dërgoi në Tropojë, Beqir Ndoun. Ky takohet me Hysni Zaimin që ishte nësues në Rrugë të Gashit, Kërrnajë. Përsëri në dhjetor të atij viti PKSH e dërgon në Tropojë dhe e ngarkon me detyrë mobilizimin e njerëzve në luftë. Lidhjen do ta mbante me Gjakovën ku ishte formuar celula e parë komuniste shqiptare me Emin Durakun sekretar për Gjakovën, Malësinë (Tropojën) dhe Podrimën. Ai u përpoq sa mundi të përhapte idetë antifashiste të luftës; bashkëpunoi edhe me individë të ndryshëm, kryesisht nga shtresa të varfëra e të mesme të popullsisë, por edhe nga me individ nga radhët e parisë Tropojës, pse lufta do të ishte gjithëpërfshirëse. Si rrjedhim në pranverë të vitit 1942 u krijuan tri njësite partizane, i Gashit, i Krasniqes dhe i Bytyçit. Më 3 maj 1942 në shtëpinë e Zeq Hysenit në Tpla formohet celula e parë e PKSH për Malësinë e Gjakovës me Beqir Ndoun, Veli Niman Doçin, Mal Sadik Malaj, Zeq Hyseni, Ali Ukshin Margjeka. Celula mori përsipër udhëheqjen politike të luftës.

Lidhja e bashkëpunimi i njësiteve me njëri-tjetrin çoi në organizim më të lartë luftarak, në atë të çetës antifashiste që u emërua Çeta e Malësisë. Kjo ishte çeta e dytë në Shqipëri pas asaj të Pezës. Kështu me 12 maj 1942 u bë takim i tri njësiteve të Guri i Lumit në Grykë të Dragobisë. Çeta zgjodhi komandant Ram Mujen, komisar Fadil Hoxha, z/komandant Shaban Haxhi Paci nga Bytyçi, Mal Sadik Malaj nga Gria, Ali Ukshin Margjeka nga Bujani, Ram Sadiku nga Luzha, Rexhep Zeqa nga Tplani, Imer Zeneli nga Kovaçi, Ahmet Sadria nga Luzha, Hasan Haxhi Paci, Idriz Dini. Ishte një sukses i rëndësishëm, sepse ishte çeta e përbashkët me komunistëve me nacionalistët me të njëjtin qëllim: luftë kundër pushtuesit italian për çlirimin e vendit.

Kjo veprimtari organizuese dha efektet e para; këputen linjën telefonike në Qafë të Luzhës dhe në Ahmataj; Prenë litarin e lundrës (trapit) mbi Drin në Vaun e Fierzës nëpërmjet të cilit lidhej Tropoja me Pukën. Gjatë verës u kryen edhe disa aksione kundër postave të xhandarmërisë në Babinë, Dragobi, Kolgecaj. Në korrik u prenë linjat telefonike midis Gjakovës dhe Pejës. Çeta mori pjesë aktive edhe në aksionin kombëtar të prerjes së linjave telefonike, tela e shtylla në Bytyç, në Qafë të Luzhës, në Okol të Gashit etj duke paralizuar komunikimin shtetëror e ushtarak në gjithë Shqipërinë. U shtua numri i të



arratisurve nga ushtria. Ata dilnin kaçakë në mal e pastaj një pjesë e tyre i bashkoheshin çetës së malësisë. Kështu bënë edhe ata që nuk pranonin të shkonin ushtarë. Çeta kryente punë sqaruese e bindëse që fshatarët t'i mobilizonte në luftë. Kjo ishte shumë e vështirë, sepse përplaseshin qëndrime, pro e kundër luftës. Në anë të pushtuesit ishin njerëz me influencë, që kishin njohje e autoritet në popull.

Heqja e kufijve të 1913 dhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nga ana e Italisë krijoi një mendësi të re, sikur pushtuesi na kishte çliruar. Në fakt, Kosova dhe territoret e tjera shqiptarëve jashtë kufijve politik të vitit 1913, ishin ndarë në tri zona pushtimi italian, gjerman dhe bullgar. Këto zona u quajtën "toka të liruar" dhe u administruan nga "shteti shqiptar"; u hapën shkolla fillore dhe Shqipëria dërgoi mbi 560 mësues. Administratorët e komunave e prefekturave ishin shqiptarë. Gjithë këto për shumë njerëz krijuan bindje profashiste. Me gjithë këtë lëvizja u shtua me luftëtarë, lëkundë një masë njerëzish për politikën dredharake të italianëve; vuri në ndjenjë frike administratën dhe postat e xhandarmërisë.

Çeta e Malësisë bënte takime e aksione të përbashkëta me çetën "Zenel Hajdini" dhe "Emin Duraku" të Kosovës. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1942 dhe vitit 1943 u shtuan aksionet e përbashkëta të tri çetave. Përmendim: Aksionin e prerjes së linjave telefonike Gjakovë-Pejë-Prizren; atentatit kundër spiunëve Beqir Maloku e Nazmi Kryeziut; pjesëmarrje në demonstratat me 28 nëntor 1942 në Gjakovë ku morën pjesë 4000 vetë; me 2 janar aksioni kundër një autokolonë ushtarake italiane në rrugën Prizren-Ferizaj ku u vranë disa ushtarë; aksioni në rrugën Gjakovë-Pejë në shkurt 1943 kundër punonjësve të financës, megjithëse ishin të shoqëruar me xhandarë, u morën 25 mijë franga. Këto u përdorën për nevojat e çetave. Në kohë të shtimit të terrorit fashist, në janar-shkurt 1943, tri çetat u tërhoqën e u vendosën në Shkëlzen, jashtë rrezikut.

KRIJIMI I KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONALÇLIRIMTAR PËR MALËSINË E GJAKOVËS 10 MARS 1943. AKSIONI NË QAFË-SHLLAK TË SHUMËRISË

Fitoret e arritura në vend dhe në botë u shtuan besimin forcave antifashiste që të dendësonin aktivitetet antifashiste. Edhe në Malësinë e Gjakovës-Tropojë lindi nevoja e ngritjes së luftës në një shkallë të re. Me porosi të celulës së partisë, më 10 mars 1943 në fshatin Bërbat-Shkelzën u bë mbledhja e 25 përfaqësuesve partizanë e nacionalistë, të cilët pas diskutimeve për gjendjen e detyrat që dilnin, zgjodhën Këshillin e Parë Antifashist Nacionalçlirimtar të Tropojës të përbërë me 7 anëtarë kryesie. Ata zgjodhën kryetar Tahir Hoxhën, i cili nuk e pranoi detyrën dhe u largua. Ky veprim shënoi krisjen e parë midis forcave partizane dhe atyre nacionaliste. Mbledhja zgjodhi Veli Niman Doçin kryetar. Këshilli ngarkoi me detyra anëtarët për ngritjen e këshillave

në të gjitha fshatrat e rrethit; forcimin e besimit për fitoren e luftës; shtimin e çetës me luftëtarë të rinj; sigurimin e ushqimit dhe të strehimit të çetistëve. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe luftëtarë nga Kosova.

AKSIONI I ÇETAVE NË QAFË-SHLLAK TË SHUMËRISË

Detyra kryesore e këshillit ishte zgjerimi i luftës. Çeta e Malësisë dhe "Emin Duraku" e kryen një aksion të rëndësishëm kundër një autokolonë që po udhëtonte nga Shkodra për në Prizren. Çetistët, më 15 mars, kaluan Drinin duke u lidhur me litarë, zunë pritë në Qafë-Shllak të Shumërisë. Sulmi ishte i befasishtëm dhe rezultati pozitiv. Pati disa ushtarake të vrarë e të plagosur. U shkatërruan 10 automjete; u morën 32 pushkë, 2 mitraloza; disa arka me fishekë; një sasi e madhe veshmbathje e ushqime. Forcat partizane kaluan përsëri Drinin dhe më 17 mars u përqëndruan në Malin e Dobrejt të Luzhës. Ndërkohë forcat ushtarake italiane, në shënjë hakmarrje, hynë në fshatin Mëgull, vranë disa burra të pafajshëm dhe dogjën tetë shtëpi.

Analiza që iu bë këtij aksioni, nxori në shesh kontradiktat të thella midis pjesëmarrësve. Komandanti i çetës Ram Muja doli hapur kundër aksioneve, hoqi dorë nga detyra dhe bashkë me disa të tjerë, u largua. Çeta pësoi një tronditje të thellë. Komandant u emërua Shaban Haxhi Paci. Çeta mori emrin e ri "Bajram Curri"; ndërsa ajo "Emin Duraku" u largua nga Malësia e Gjakovës. Kjo mori përsipër që të shtojë aksionet, sepse vetëm me aksion e luftë do të fitohej liria.

Armiku shtoi forcat ushtarake në qendër të Tropojës. Reaksioni u gjallërua dhe bashkë me italianët e shtoi aktivitetin. Në Okol të Gashit, në korrik, u bë një mbledhje e organizuar nga paria, ku morën pjesë nga gjithë Malësia. I deleguar nga Tirana ishte Ded Qoku, një profashist, i cili shpalli amnistinë për të gjithë ushtarët e arratisur, kërkoi vendosjen e besëlidhjes për të luftuar partizanët me çdo mjet. Besëlidhja nuk ia arriti qëllimit për shkak të konflikteve të ashpra që u shfaqën. U bë thirrje për një bashkim të ri forcash. Por situata po ndryshonte me shpejtësi që çoi në kapitullim Italinë Fashiste me 8 shtator.

BESËLIDHJA E MALËSISË SË GJAKOVËS MË 28 GUSHT TË URA E VALBONËS NË KOLGECAJ

Çeta nëpërmjet anëtarëve njoftoi për këtë tubim dhe për rëndësinë e tij, duke synuar bashkimin e të gjithëve në Frontin Nacionalçlirimtar. Por edhe paria nga ana e saj kishte bërë thirrje që të krijonte një front kundër partizanëve. Morën pjesë afro 1000 vetë. U shpalosën pikëpamje e qëndrime krejt të kundërta. Çeta partizane "Bajram Curri" hodhi kushtrimin për bashkim të gjithë njerëzve pa dallim feje, ideje, shtrese shoqërore e krahine, të gjithë bashkë luftë kundër pushtuesve. Folën me këtë rast: Veli Niman Doçi, Beqir Ndou, Fahri Ramadani, Hasan Haxhi Demaliaj, Mal Sadik Malaj e tj, të cilët treguan arsytet pse ishte bërë ky tubim. Shumica e pjesëmarrësve u shprehën në krah të luftës për çlirim.

Ky tubim ishte deri atëherë suksesi më i madh i celulës së partisë dhe i çetës për të bindur popullin që të luftojë kundër fashizmit.

LUFTA PËR ÇLIRIMIN E GJAKOVËS NGA ITALIANËT MË 7-10 SHTATOR 1943

Forcat ushtarake italiane që ndodheshin në Huk të Tropojës, nga fundi i gushtit, kishin ikur fshehurazi natën për në Gjakovë, ku ishin grumbulluar rreth 4 mijë ushtarë e karabinierë italianë dhe bashkëpunëtorë të tyre nga Gjakova me rrethinë. Çeta "Bajram Curri" mbas Besëlidhjes së 28 gushtit shtoi radhët dhe më datën 7 shtator, në koordinim me çetën "Emin Duraku", "Zenel Ajdini" dhe njësitin e Hasit rrethuan Gjakovën. Me gjithë pengesat që sollën tradhëtarët Hasan Kryeziu e Ismet Shaqiri të Gjakovës, u zhvilluan tri ditë luftime të ashpra. Ato

(Vijon në faqen 9)

HISTORIA

Sadi Sinani, dëshmor i parë i Pezës

Nga: Liliana Muça

Në kuadrin e 75-vjetorit të Çlirimi të Atdheut, të kësaj feste të madhe jubilare, kujtojmë e nderojmë ata, të cilët derdhën gjakun dhe falën gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre. Në plejadën e lavdisë kombëtare, qëndron edhe Sadi Sinani, një ndër pesë dëshmorët e parë të Pezës heroike, të djepit të lirisë, të tokës së djegur e të zhuritur, shkëndijë e luftës partizane.

Sadiu lindi në fshatin Maknor të Pezës, në vitin 1910. Ishte i biri i Mersin Sinanit, baba i dy djemve dhe një vajze. Mersini, si dhe djali i tij i madh u ndanë shpejt nga jeta, kështu që pesha e familjes, me hallet e shumta të kohës, i mbeti të shoqes dhe Sadiut, në atë kohë vetëm shtatëmbëdhjetë vjeçar. Pikërisht në këtë moshë të re, i mundësuan martesën ku erdhën në jetë katër vajza; Fitnetja, Dersja, Zoja dhe Nasija. Shtëpia u mbush plot, por edhe hallet u shtuan, sepse nuk e pati një djalë që t'i dilte krahë në punët e shumta të bujqësisë, siç qe shprehur ndër miq e shokë.

Por ia gjeti anën edhe këtij halli duke mundësuar punimin, të mbjellat dhe të korrat e 11 ha-tokë me punëtorë argatë. Për fat të mirë, prodhimet filluan të vinin të mbara dha hambarët mbusheshin plot, por shumë familje pezake vuanin fukarallikun, dhe Sadiu me atë shpirtin e tij babaxhan u mundësonte thasë me misër apo grurë falas, veprim i cili e bënte atë shumë të dasur dhe të respektuar nga bashkëfshatërt e vet.

Me shkakthtësinë që e karakterizonte ndoqi rrugën e tregtisë, duke shfrytëzuar marrëdhëniet fafeshnore me dy prej familjeve të bejlerëve në Ndroq; me Beqir Currin dhe Hasan Mansakun. Të bijat tregojnë se; Kur hipte në atë kalin e murrme, të cilin i shkëlqente qimja, veshur me atë këmbishën e bardhë qelshen si borë të kthyer pak mënjane në ballin e gjerë dhe xhokë e zezë, ku përmes kraharrit i vezullonte qosteku i sahatit, ne thoshim me krenari se sa të hijshëm e kemi babën. Kështu vishej zakonisht



kur merrte rrugën për të bërë tregti dhe nëna i hidhte një kovë me ujë nga prapa për t'i ecur mbarë... Vitet kalonin dhe Sadi Sinani po fitonte më shumë përgjegjshmëri për situatën në Shqipëri. Nuk vonoi dhe këmba e okupatorit italian shkeli më 7 Prill 1939 tokën shqiptare. Sadiu krijoi bindjen e plotë se e fatin e Shqipërisë mund ta zgjidhte vetëm gryka e pushkës. Ndërkohë, si bir i vegjelisë u hodh si luftëtar aktiv në çetën e Pezës, e cila udhëhiqej nga Babë Myslymi. Shtëpia e Sadiut u bë një ndër bazat kryesore të luftës për Çetën e Pezës, edhe më gjërë. Aty strehoheshin dhe bënin kuvendime për organizim betejash; Myslym Peza, Mustafa Gjinishi, Kajo Karafili dhe Myrvete Peza. Nënë Dumja i priste e përcillte luftëtarët e çetës, ua shtronte sofrën me bujari dhe u thurte triko e çorape leshi. Vajza e vogël e Sadiut, në atë kohë 8 vjeçe, Nasija, kryente punën e korrierit. Kajo karafili i jepte letrat për t'i dërguar në bazën e çetës dhe në pikat ku priteshin të kryeshin aksione.

Aksionet vazhdonin njëri pas tjet-



trit dhe Sadi Sinanin si gjithmonë e gjeje në ballë të tyre; në prerjen e shtyllave telefonike dhe në prita të kolonave fashiste. Ishte koha, kur populli shqiptar ishte ngritur në këmbë për të mbrojtur truallin nga barbarët, kur Çeta e Pezës dhe luftëtarët e saj u bënë shembulli i sakrificës dhe i heroizimit, frymëzimi i idealit të lirisë.

Dhe vjen një ditë, 16 mars 1941, ku në një pritë me fashistët italianë bie dëshmor i atdheut Sadi Sinani dhe katër luftëtarë të tjerë të çetës; Muharrem Haka, Xhaferr Durishti, Vath Korriku dhe Hasan Peza. Në momentin që vritet Sadiu, xhaxhai i tij Kasem Sinani të cilin e kishte patur në krahë të pozicionit të luftimit, i keqardhur për të nipin dhe i motivuar nga urrejtja dhe ndjenja e hakmarrjes, vendos t'iu bëjë një rrëng këmbishzinjve. Vendos në një dru aty pranë qelshen e tij duke i bërë fashistët të devijojnë të shtënat drejt objektit fallco. Duke përfutur nga situata Kasemi u merr krahët dhe vret shumë prej tyre.

Fashistët italianë, megjithëse të armatosur gjer në dhëmbë, po pëso-

nin humbje të njëpasnjëshme në bazë materiale dhe forca numerike prej luftëtarëve të çetës. Manovrat e tyre ishin çnjerëzore; dogjën shtëpi, therën bagëti e vranë njerëz të pafajshëm. I gjithë fshati Maknor u bë shkumb e hi, por ky veprim i fashistëve nuk e mposhti rezistencën e pezakëve. Çetës iu shtuan qindra luftëtarë të rinj, të ardhur nga e gjithë Shqipëria. Lugina e Pezës oshëtinte nga krismat e pushkëve dhe gjëmimet shurdhuese të bombave. Populli u ngrit në këmbë me pushkë në krahë e këngë në gojë për bijtë e tij, dëshmorë të lirisë.

*Ti moj Pezë vend baroti
Ti nuk derdhe një pikë loti
N'Pezë ranë dëshmorët e parë
Rrema, Xhafa dhe Hasoni
Vath Korriku e Sadi Sinoni*

*Babë Myslymi komandon
Gjithë lugina po gjëmon
Hakun shokëve me ia marrë
Një me njëzet të vrarë.*

Me vendim të Presidentit të Kuvendit Popullor, Sadi Sinanit i është akorduar "Medalja e Trimërisë" si Dëshmor i Atdheut. Ndësa vajzat kanë merituar statusin – Veteran i Luftës. Të pestë dëshmorët prehen në vazrrezat e Dëshmorëve në Pezë. Familiarë, nipër e stërnipër të Sadiut e kujtojnë me respekt e krenari gjyshin e tyre. Çdo 5 Maj dhe 16 Mars, ata presin vizita përkujtimore nga pushteti vendor, autoritete të larta të shtetit dhe bashkëfshatarë të tyre.

Më 5 Maj, në diën përkujtimore të Dëshmorëve të Kombit gjenden: Agim Rabeta, Avdulla Rabeta, Sadi Rabeta, Nexhmije Rabeta, Sherife Rabeta, Nazmie Rabeta, Ramazan Lapraku, Bukurie Lapraku, Zija Kalaja, Telha Kalaja, Fatbardha Kalaja, Sherife Kalaja, Naile Kalaja, Zeqine Kalaja, Dhurata Kalaja, Vesel Kalaja, Idajet Kalaja, Xhavite Kalaja, Violeta Kalaja, Arta Kalaja, Flora Kalaja, Natasha Kalaja dhe Afërdita Kalaja.

Do kalojnë dekada të tjera, por gjaku i dëshmorit Sadi Sinani do jetë gjithmonë lavdia e kombit dhe nderi e krenaria e familiarëve brez pas brezi.

MALESIA E GJAKOVËS - TROPOJA NË LUFTËN ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE (1939-1945)

(Vijon nga faqja 8)

përfunduan me fitorën e forcave partizane, të cilat çliruan qytetin më datën 10 shtator; u liruan më se 40 të burgosur politikë. Forcat ushtarake italiane dhe bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë, me humbje të shumta në njerëz e materiale, u larguan. Në këto luftime ranë dëshmorë 28 luftëtarë si Sherif Nuh Gjonaj, Ibish Zymer Imeraj, Halil Hamëz Malaj, Hasan Ahmet Malaj, Brahim Syl Mustafaj e tj. U plagosën mbi 40 partizanë të tjerë. Shumica e pjesëmarrësve në luftime u kthyen nëpër fshatrat e tyre.

Në rrethana të tilla në Gjakovë zbarkuan forcat ushtarake gjermane. Çeta u tërhoq. Pas disa ditësh udhëtimi arriti në Plavë e Guci në ndihmë të luftës që bënte atje çeta e kësaj krahine.

NGA ÇETA, NË TRI BATALIONE PARTIZANE

Besëlidhja e Malësisë ndikoi në shtimin e partizanëve. Prandaj pas lufts në Gjakovë, në Gjyriq të Plavës u formua batalioni partizan "Bajram Curri" me afro 200 vetë. Komandant u zgjodh Shaban Haxhia, komisar Qamil Brovina, z/komandant Mal Sadik Malal dhe z/komisar Enver Dajçi. Në luftime me çetnikët malazezë ranë dëshmorë komandanti i

çetës së Plavës dhe të Gucisë, Hajro Shahmanaj, Hysni Zaimi, komisar i kompanisë së tretë të batalionit "Bajram Curri" e tj. Pushtimi gjerman solli probleme të reja edhe më të ndërlikuar. Forcat reaksionare, shumica nga paria vendase që u shërbyen fashistëve, u bënë mbështetësit kryesorë të gjermanëve. Kësaj situatë edhe më të vështirë duhej përgjigjur me shtimin e forcave në krah të luftës. Me punën e celulës së partisë dhe të këshillave nacionalçlirimtare u rrit numri i partizanëve. Prandaj me 26 nëntor 1943 në fshatin Tpla, me 27 në Livadhin e Shtjerrave po në Tpla, u formua batalioni Rinia me 150 të rinj me komandant Jaho Mulosmanin, komisar Mehmet Dermanin dhe z/komandant Hasan Isuf Haklaj; njëkohësisht u formua edhe batalioni territorial me komandant Mehmet Mulosmanin, komisar Xhaferr Vokshi, z/komandant Isuf Çuj Qerimaj. Të dy këto batalione rrinin të shpërndarë, por në rast thirrje, mbledheshin menjëherë në vendin e caktuar. Në këtë prag dimri në Tropojë me rrethinë kishte, 4 batalione përfshi edhe batalionin "Përlat Rexhepi" të Shkodrës që ishte në fshatrat Gri, Geghysen, Tpla e Degë.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

PROFIL

Mohimi i luftës për çlirimin e vendit rivrasje të atyre që sakrifikuan dhe dhanë jetën

PËR SAMI KUÇIN, DROBONIK BERAT

Nën peshën e kujtimeve, me shumë kujdes, e kam detyrim moral për të sjell disa momente nga jeta babait tim Sami Kuçi, si pjesë e së tërës të asaj kohe, të shkruaj amanetin e tij : për të ecur përpara duhet të harrojmë të keqen, të falim për të korrigjuar të kaluarën ndarëse të popullit tonë. Ai ishte një shëmbull bashkëjetese deri në largimin nga kjo jetë. Pas viteve 40 -të Samiu ishte në origjinë të lëvizjes nacional- çlirimtare si krijues dhe pjesëmarrës aktiv. Sipas situatës ai merrte rolin e organizatorit jo vetëm që mbeshteste lëvizjen për çlirimin e vendit me pjesëmarrje direkt në luftë të bashkëshatarëve por dhe organizonte mbledhjen e ushqimeve në zonë dhe mjete të tjera logjistike për partizanët. Dëshmi e kësaj pune të sinqertë, mbas çlirimit lokaliteti u vendos në shtëpinë tonë, e njohur «zyrë pune në odën e Samiut », zyrë për regjistrimet, celibrimet e të tjera formalitete të zonës. Gjatë luftës për marrjen e qytetit të Beratit, gjithmonë fshati Drobonik për nga pozicioni dominant geografik vlerësohej si bazë nisje për mësymjen për marrjen e qytetit, (sipas rastit)si nga partizanët, gjermanët dhe italianët ndaj shpesh ky fshat ishte fushë beteje duke krijuar situata të vështira edhe për banorët e këtij fshati.

PLAGOSJA NË DROBONIK E PARTIZANIT KADRI SEVRANI NGA CAKRANI I SKRAPARIT.

Gjatë një beteje të përgjakshme midis partizanëve dhe gjermanëve mbetet i plagosur partizani Kadri Sevrani pranë shtëpisë sonë. I ndodhur nën breshërinë e plumbave, luftim trup me trup nga ndjekja e gjermanëve, partizanët nuk mundën ta merrnin me vete, të nxituar e spostuan diku në anë të rrugës duke e fshehur pas një peme.

Gjermanët kishin ndërmarrë një kundërsulm kundër partizanëve të ndihmuar nga ballistët e zonës që ishin të shumtë. Babai tregonte se vrasja e partizanit është bërë nga ballistët (vrasësi ishte një i njohur i babait dhe ai e tregonte si akt trimërie tek gjermanët pasi partizani vinte nga zona e Skraparit) diku të vendosur tek vendi “bregu i fierit” të cilët ishin udhërrëfyes dhe bashkëluftëtar me gjermanët në këtë zonë. Në këtë kohë Samiu fshehurazi e merr të plagosurin me nxitim pa ardhur forcat gjermane dhe e strehon në shtëpi, në dhomën e fëmijëve duke i dhënë ndihmën e parë për të ndërprerë rrjedhjen e gjakut dhe e mbulon me shumë rroba për të ruajtur temperaturën e trupit mbas derdhjes gjakut, tregon babai me dhimbje. Mbas pak kohe vijin gjermanët të shoqëruar nga ballistët dhe hyjnë në shtëpi duke ndjekur pikat e gjakut. Një skenë e tmerrshme sjellje të këtyre pushtuesve ndaj viktimes dhe familjes time të treguar kaq shumë herë në vite nga babai dhe nëna ime; por në krahë të tyre ishin edhe persona nga balli kombëtar.

Sa herë babai tregonte me dhimbje se si çizmjia gjermane lëviste kokën e partizanit për të vërtetuar se ishte gjallë apo jo dhe me pistoletë në dorë për ta rivrarë por i ndodhur nën klithmat e nënës time dhe të fëmijëve te vegjël pistoletat nuk u



shkrep. I gori nuk ishte partizan, ju lutej babai por e kanë marrë me zor në luftë sipas ligjit të luftës të partizanëve. Kjo ishte disi bindëse dhe në këtë kohë ndërhyr një nga ballistët, i sjellshëm duke e mbrojtur të plagosurin, ndoshta e njohu: është i vdekur dhe e ka sjellë këtu thjesht për ta varrosur sipas tradites, kështu gjermanët largohen nga shtëpia. Partizani i plagosur kishte uniformë që tregon vullnetarizmin e tij, për fat këtë veshje babai e kishte fshehur dhe i kishte veshur rroba të tjera. Me largimin e tyre, kur situata u qetësua, babai niset për në Berat duke e ngarkuar në një mushkë nga një rrugë dytësore (rruga e maqinës), kalon lumin Osum dhe shkon direkt në spital. Në spital ndryshon fshehurazi tabelën e të plagosurit me një ballist tjetër i shtruar në krahë të tij. Nisur nga tabela e të plagosurit, “ballist” dhe nga gjendja e rëndë Kadriun e nisnin për në Tiranë për një ndërhyrje më të specializuar.

Mbas çlirimit Kadriu i shëruar kthehet tek vendi ku ishte vrarë, pranë shtëpisë, përballë portes sonë. Ai qëndroi gjatë aty ndoshta për të kujtuar ndonjë rrethanë njohje për këtë ngjarje të dhimbshme. Nëna e shikonte nga dritarja, sigurisht ky person i dyshimtë në derë të shtëpisë mbas luftës, pa trokitur në portë, me lëvizje të dyshimta ishte frikë për të pasi ndodhej vetëm.

Në pritjen e gjatë tek porta kthehet babai në shtëpi dhe mbas një pritje të ngrohtë familjare, duke kaluar natën në familjen e babait ata u bënë vëllezër. Ai filloi punën në degën e brendshme në Berat dhe më pas si sekretar i Gjykatës në Skrapar. Filluan vizitat e ndërsjellta në familje deri vonë edhe mbas vdekjes të babait tonë.

BRIGADA E VII TË SLMUESE PËR TË ÇLIRUAR BERATIN U VENDOS NË ZONËN E DROBONIKUT

Shtëpia e Sami Kuçit u bë shtab pune i brigadës të drejtuar nga komandanti i brigadës Gjini Marku. Kujtimet e babait për këtë komandant legjendar janë të shumta, i shërbeva shtabit jo vetëm për shumta, i shërbeva shtabit jo vetëm për siguri ruajtje por dhe me krijimin e

kushteve për jetesë. Ndërsa në librin e kujtimeve komandant Gjini Marku do ta vlerësonte Samiun si antar i shtabit të brigadës. Po aq tragjike ishte dhe vendimi i marrë për të ekzekutuar Nënë e Bir, Refi-jen dhe Refat Nazëri të dyshuarsi spiunë të italianëve. Ishte Sami Kuçi, i ndihmuar nga Faik Gërxhi që garantuan jetën e tyre si dëshmitarë për këta të pafajshëm Nënë e Bir; ishin këta dy burra që rrezikuan jetën e tyre që nuk u vranë këta dy të pafajshmit e fshatit Drobonik.

LUFTA NË SHPIRAG TË BERATIT

Nga çeta e Shpiragut u kërkua ndihmë për disa djem nga Droboniku për të shkruar në luftë. Sipas ligjit të luftës i caktonte Samiu dhe në rast refuzimi ishte dhe dërgimi me forcë. Çeta e Shpiragut ndodhej në rrethim nga gjermanet dhe kërkonte luftëtarë nga fshatrat për rreth tregonte shpesh babai në bisedat e tij për luftën. Si kryetar këshilli n-çl e kisha për detyrë që ti caktoja djemtë e fshatit për luftë. Në këtë situatë të vështirë lufte vendosa vullnetarizmin e bashkëshatarëve të mi por nuk funksionoi, asnjëri nuk donte të shkonte.

Ishim mbledhur të gjithë tek sheshi i fshatit dhe për shumë kohë unë kërkova daljen vullnetare për në lufte por askush nuk guxonte të dilte. Ishte e pamundur të niseshe në atë situatë ku gjëmonte artileria e rëndë jo shumë larg nga Droboniku. I vendosur në pozicion të vështirë zgjodha vetvehten. Mora pushkën dhe iu drejtova burrave të fshatit: çeta është në rrezik dhe kërkon ndihmën tonë. Berati do të çlirohet sa më shpejt dhe kërkoni forcën e djemëve tanë dhe ne duhet të shkojmë. Zgjodhja do të jetë kjo: do të shkoj Unë dhe dola në krahë të turmës. Me mua do të shkonjë në luftë: Ti, ti, ti ...u bëmë disa dhe u nisëm në heshtje për në lufte.

NJË TJETËR NGJARJE, DHIMBJE PËR BABAIN DHE KRENARI PËR FAMILJEN TONË

Për pushtimin e Beratit gjermanet ishin dislokuar në fshatin Drobonik.

Ardhja e tyre ishte e mirepritur nga ballistët e kësaj zone të cilët spiunionin aktivitetet e lëvizjes kundër tyre. Babai im kishte krijuar keshillin n-çl të zonës dhe drejtues i tij (kryeplak) detyra këto që e bënin target për pushtuesit. Gjermanet mbërrijne në fshat dhe në mesnate ata e arrestuan duke terrorizuar familjen. Ishte një dramë që ndodhia nuk mund të shprehet me fjalë, nga çfarë ishte në realitet. Për shumë kohe ata e lidhën pranë një peme në pyllin diku afër shtëpisë duke e kërcënuar me jetën. Ai priste nga çasti në çast zbrazjen e pistoletës në gojën e tij nga ushtari gjerman. Në pritje të jehonës të krismës sigurisht ka fantazuar lloj lloj dhimbje të frikshme....që kurrë nuk i tregoi. Ai përjetoi minuta të tëra lëvizjen boshe të mekanizmit të shkrepjes të pistoletës, por fatmirësisht nuk u zbraz, fal ndihmës të një tjetri shqiptar, shoqërues i këtyre gjermanëve. Isha student dhe sapo kisha lexuar Dostojevskin, i ndodhur edhe ai para një skuadre pushkatimi që ngriti pushkët dhe mori shënjestër drejt tij. Heshtje totale, e cila u thye shumë shpejt, jo nga tingujt e tërheqjes së këmbëzave, por nga një urdhër për pushkatarët që të ulnin pushkët. Në sekondën e fundit ai shpëtoi nga vdekja. Ai mbronte letërsinë e ndaluar nga Nikola I, Perandori i Rusisë. Dostojevski u lirua nga burgu pesë vjet më vonë dhe shkroi libra të tillë klasikë, “Krim dhe ndëshkim”. Babai im edhe pse përjetoi më gjatë tingujt e tërheqjes së këmbëzës të pistoletës, jo në distancën e skenës së Fjodorit por pak centimetra nga frymarja e tij; ai shkroi me sjelljen e tij librin “Të falim dhe të duam njeri tjetrin”.

Mbas çlirimit deri në vitet 60-të ai ishte i ftuar në podiume ceremonial, ishte krenar por më pas u harrua; deri në këtë vit protokolli bëhej nën kujdesin e Kahreman Yllit një shok i respektuar i babait tim që ai e kishte personazh shprese dhe respekti në jetën e tij mbas çlirimit.

Shtëpia jonë u nderua me pllakën “Bazë e lëvizjes nacional-çlirimtare”. Ai i gëzonte kësaj pllake dhe e ruante si të shënjtë.

Zaim Kuçi

REPORTAZH

Fundjavë shkencore në Meteora

Dr. Leonidha Peppo

Kardiolog - Poliklinika nr 4 , Tirane

Fundjava, përveç psikologjisë të pushimit, kësaj rradhe na rezervoi një tentativë të mbyllur me shumë sukses, si në fushën e mjekësisë dhe në atë të ngritjes shpirtërore dhe entuziazmit të madh të gjithë grupit tonë, shumica farmacistë, por edhe mjekë në një udhëtim turistik të organizuar nga kompania farmaceutike “BOSNIA LIEK”.

Sigurisht për të mësuar për ilaçet e reja në fushën e mjekësisë u rrit shumë interesi i pjesëmarrësve me kompani turistike. Kjo shton më tepër kënaqësinë tonë duke u bërë grup i këndshëm edhe nëpërmjet guidës me pyetje – përgjigje.

Po le të kthehemi tek qellimi kryesor: udhëtimi turistik - shkencor që u zhvillua në qytezën Mestonovo prej 7 mijë banoresh dhe pikërisht në hotel “Egantia” që të kujton rrugën me të njejtin emër e që zanafillën e ka nga bregdeti shqiptar nëpërmjet mezit të Shqipërisë, në periudhën romake dhe në vazhdim në Greqinë e sotme deri në detin Mesdhe. Në këtë hotel kaluam natën dhe të nesërmen pas mëngjesit të shijshëm u rregullua salla e seminarit me imazhe reale, të lidhura me teknikim në televizor dhe stendat shkencore përkatëse, me një interesim maksimal të të gjithë pjesëmarrësve, në mënyrë të veçantë për barin Lisojbact spray me rezultat shumë të mirë nga përdorimi i tij. Këtë prezantim e bëri doktoresha e otorinolaringologjisë të Poliklinikës së Specialiteteve nr 3, Tiranë, Anjeza Kuçi, e specializuar edhe spitalin Hypokrati. Ajo që mjaftë e gjallë, e qartë, tërheqëse, dhe e aftë, duke



tërhequr në maximum pjesëmarrësit farmacistë e mjekë dhe duke i bindur për efektet pozitive të këtij ilaci në hapësirën e gojës, një ilaç që ja vlen të përdoret nga nevojtarët, aq më tepër që doktoresha që mjaft bindese në argumentimin e përfitimit ndaj tij.

Ky aktivitet u bë i mundur nga doktor Afrim Ibrahimi, drejtor i zyrës në Tiranë të kompanisë Bosnia Liek - ish i burgosur në burgjet e Milosevic të Jugosllavisë; prej kohësh i zhvendosur nga Tetova në Tiranë bashke me familjen e tij. Dikur kjo kompani ishte e pranishme në Shqipëri me sukses. Më vonë u vanit dhe tani nën udhëheqjen e re nga dr. Afrimi me ndihmën Klajdi Nallbani dhe një i thirrur Çimi shpreson të ringrihet lart. Ajo filloi me paraqitjen e barnave

pak të njohura si lisinopril (lopril) për hipertensionin arterial, suplemente të tjera ushqimore apo ilaci i fytyrës sipërpërmenduri me aftësi nga doktoresha Anjeza Kuçi.

Ja dhe destinacioni: Nisja e grupit në orën 5 të mëngjesit, ndalim i shkurtër në Tepelenë, dhe pastaj Janina e njohur e Shqipërisë, tashmë e Greqizuar. Vizita e kalasë së Ali Pashë Tepelenës me mure guri të trasha.... Aty është edhe varri i Pashait pa kokë, me gruan e parë Emira (se dihet që koka është në Stamboll) si dhe kënga e njohur që e thotë këtë. ..Dhe gruaja e dytë, Vasiliqia, 40 vjet më e re, e cila iu ofrua për martesë pasi vdiq Emineja. Brenda kalasë janë dy muzeume, njëra islame dhe tjetra kishë.

Ndërsa dreka ishte në restorantin aty afër, pasi kaluam qytetin. Racionet ishin të shumta, sa menduam se sa hanë këta grekët !!! Por humbën vajtjen në ishullin e liqenit ku është dhe muzeumi i Ali Pashës, ku janë armët, dhomat e banesës, pikturat nga jeta dhe lufta e pashait. Keqardhje që nuk e vizituam se nuk premtoi koha. Vizituam qytezën e Mestonovës që ngjante me Beratin apo Gjirokastrën, me organizim të mirë për 700 mijë banorë, me asfaltet dhe kalldrimet, me restorante të shumta, dyqane floriri deri dhe disko. Pak me lart kishte pista për ski profesionistësh dhe për amatorë.

Fjetja në hotel Egnatia na kujtonte dhe rrugën me të njejtin emër që

kalon nga deti nëpër Shqipëri deri në Greqi.... Koha e romakëve....Të nesërmen pas ngrënies së mëngjesit u zhvillua seminari i përmendur që në fillin të këtij reportazhi. Shpejt u nisëm për në Meteora që ishte qëllimi kryesor i këtij udhëtimi. Në autobus vazhdonte muzika dhe barsaletat, ahengu që i bënte entuziastë pjesëmarrësit. Meteora ishte një mrekulli e vërtetë e natyrës; shkëmbinjtë gri në ajër...Në majat thikë të shumta shkëmbore ka 25manastire të ndërtuara në shekullin e XV që të shpëtonin nga pushtimi turk dhe të mos ndërronin fe. Janë 5 të tillë të populluara nga murgj dhe murgesha, kuptohet të veçuar. Kishte shkollë dhe tunele të vegjel për të shkuar deri aty. BUKURI e RRALL!!


Por ne pamë me hollësi manastirin më të madh, ku grave vizitore që në hyrje u jepnin funde basme që të mbuloreshin!! Aty kishte dhe muzeume të librave të vjetër, antikuare dhe kodikë, natyrisht me përmbajtje fetare por që më tepër na tërhoqi ne si çift me gruan time Etleva, si specialiste e kësaj fushe, (që i kemi edhe në shtëpi). Pjesa tjetër e muzeut kishte ikonat e ndryshme, pa të cilat nuk kuptohen vendet e shenjta. Por si i kanë ndërtuar vallë? Psh, shkëmbi në formë si 15 katëshi që ka në majë manastirin. Duhet të shkosh e të shijosh!! Vizitorët ishin të shumtë, me vetura dhe autobuzë. Foto të shumta, të fiksuara në celularët tanë që do i shohim gjatë edhe ne e brezat e pasëm, duke ju shtuar kuriozitetin dhe dëshirën për ta parë e vizituar. Kësaj vizite ju shtua edhe ngjitja e katër alpinistëve në këto shkëmbinjtë të mprehtë, sa dhe për t'i parë të vinte frikë. Poshtë Meteoras shtrihet fshati Kallamak, ku hëngrëm edhe drekë sipas kërkesës personale. Fati i madh që moti na mbajti mirë për të parë këto bukuri përrallore. Kthimi në rrugët shumë të bukura nëpërmjet 10 tuneleve, mes mjergullës që kur lartësia u ul u zhdruk. Kthimin e bëmë me çiftin Afrim e Lavide Ibrahim, me veturë, duke patur keqardhje që lamë grupin e mrekullueshëm të autobuzit me farmacistë e mjekë, me biseda tërheqëse e humor.

Kthehemi në shtëpi të dielën, për të filluar javën me punën dhe jetesën e përhershme. Gjatë rrugës lumi tërheqës Vjosa, e cila duhet të ruhet nga ndërhyrjet e ndryshme për HEC-et, por që janë edhe të nevojshme.

Të tilla takime paçim përherë!

Prof.dr.Shefqet Hoxha jep dorëheqjen nga OBVL

Një ditë para Kuvendit të 7-të të OBVL, gjatë një bisede telefonike, si dhe ditën e Kuvendit, para se të fillojnë punimet e tij, u dakortësua



që njëri nga katër nënkryetarët e OBVL të zgjidhej prof.Dr.Shefqet Hoxha. Kjo, në vlerësim të personalitetit të tij si një nga studjuesit dhe historianët më të mirë të vendit, por edhe për origjinën e tij, nga Luma me histori të lavdishme, nga ku kishte lindur edhe gjeneral Rrahman Parllaku, që e drejtoi organizatën tonë me përkushtim dhe vizion bashkëkohor për dy dekada. E bëmë këtë sqarim në respekt të personalitetit të prof.Shefqet Hoxhës, pasi ai vetëm dy ditë pas Kuvendit, me një letër drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OBVL, z.Halil Rama, jep dorëheqjen nga kjo organizatë, (kuptohet edhe si nënkryetar i OBVL). Më të plotë lexoni faximilen e letrës së prof. Dr.Shefqet Hoxha.

Kryesia e OBVL dhe redaksia e gazetës “VETERANI” i uron jetë të gjatë e të lutur dhe krijimtari sa më produktive e cilësore prof. Dr.Shefqet Hoxhës.



PROMOVIMI

OBVL dhe Shtëpia Botuese "M&B" prezantojnë librin e 20-të të publicistit, poetit e shkrimtarit Sakip Cami

“LANÇ në Dibër”, vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare



(Vijon nga faqja 2)

Prof.dr.Bernard Zotaj, duke evidentuar vlerat dhe veçoritë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër, ndër të tjera tha se “ Përmes këtij libri autori sjell ndihmesën e tij në trajtimin e plotë dhe mbi baza dokumentare të njërës prej zonave më të veçanta e më të mëdha si Dibra, për kohën kur veproi, duke sjellë njëherësh dhe një ndihmesë të çmuar në fushën e Historisë Ushtarake Shqiptare. Autori është përpjekur dhe i'a ka arritur të rindërtojë të plotë imazhin e kësaj zone luftarake, me veçoritë e veta dalluese si në organizim ashtu edhe në veprimtarinë e dëndur luftarake, pa lënë jashtë trajtës edhe rolin e spikatur të saj, si një burim njerëzor për ngritjen e çetave, batalioneve dhe të brigadës sulmuese. Në punim, për herë të parë jepet e tërë skema e veçantë organizative, e plotësuar tashmë dhe me të dhënat për drejtuesit kryesor, si dhe me dukuritë e risitë e veprimtarisë luftarake të njësive që vepruan në Dibër. Madje aty sillen në mënyrë të plotë mjaft të dhëna e statistika përmbi formacionet ekzistuese para krijimit dhe të tjerave që u formuan më pas, gjatë veprimtarisë së luftës”.

Më tej, Prof.dr.Zaho Golemi – ish-Drejtor i Arkivit të Ministrisë së Mbrojtjes,



pasi përgëzoi autorin për këtë vepër dinjitoze, tha se Dibra radhitet ndër rrethet me numrin më të madh të dëshmorëve.

Rreth profilit krijues të autorit Sakip Cami, autor i 20 librave me poezi, prozë, monografi e studime, foli kryetari i Unionit të krijuesve dibranë, z.Fatos Daci që është njëherësh edhe anëtar i Akademisë shqiptaro-amerikane të Shkencave.

Ndërsa studjuesi Mehmet Hasani foli për veçoritë e LANÇ në zonën e Gollobor-dës, të pasqyruara gjerësisht në këtë vepër të autorit S.Cami.

Vlerat krijuese të këtij autori i eviden-

toi më dukshëm administratori i Shtëpisë Botuese “M&B” Bujar Karoshi, i cili veçoi seriozitetin e z.Cami në mbledhjen dhe trajtimin e fakteve, cilësinë dhe produktivitetin në krijimtarinë e tij letrare e publicistike. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet promovues i përshëndeti edhe nënkryetari i OVLANÇ të Kosovës, publicisti i mirënjohur Bashkim Hisari. Pasi uroi autorin Cami për këtë kontribut të çmuar në historiografinë e re shqiptare, ai tha se promovime të tilla janë një shembull frymëzimi edhe për drejtuesit e OVLANÇ të Kosovës. Rreth vlerave të librit dhe për

• Në këtë aktivitet promovues të librit të autorit Sakip Cami “LANÇ në Dibër”, interes të jashëzakonshëm ngjalli kreu i OBVL, kol.ing.Myfi t Guxholli. Si pjesëmarrës aktiv në LANÇ, ai rrëfeu për pjesëmarrësit kohën kur i inkuadruar në Brigadën e IV-t Sulmuese mori pjesë në luftimet në Zërqa, Dibër të Madhe e Peshkopi, kundër pushtuesve gjermanë dhe mercenarëve vendas të lidhur me pushtuesin.

• Duke përshëndetur pjesëmarrësit e shumtë në këtë aktivitet promovues, zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi vlerësoi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si një zgjedhje politike dhe ushtarake të mençur dhe dinjitoze të popullit shqiptar. Pasi përgëzoi autorin Sakip Cami për këtë vepër dinjitoze, numri dy i dikasterit të Mbrojtjes tha se: “LANÇ ishte një përcaktim politik dhe ushtarak i Shqipërisë në krahun e duhur gjatë Luftës së II-të Botërore. Jemi krenarë për mençurinë, sakrificën dhe përkushtimin ushtarak të partizanëve që bënë LANÇ dhe të popullit tonë antifashist”

ngjarje konkrete të LANÇ në Dibër foli edhe ish-ministria e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami. Në këtë atmosferë festive, për pjesëmarrësit u shtrua dhe një koktejl.

